

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7348 E enjte 9 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga VASIL KURETA



Njëqind vjet më parë u zhvillua ngjarja më e rëndësishme historike, që njihet si Revolucioni Bolshevik. Në përballjen filozofike, politike e sociale mes bolshevikëve ...
Vijon në faqen 19

Një shekull nga fitorja e revolucionit të tetorit, me realizëm, pa nihilizëm



Opinion i Ditës

Nga ERVIN QAFMOLLA

Këno", urdhëroi mësuesja. Belkëzova tri apo katër nota, pastaj automatikisht mbulova fytyrën me duar. Nuk kam qenë ndonjëherë nxënës ...
Vijon në faqet 20-21

Terror në klasë: Kujtimet shqiptare të një fëmijërie të thyer



Droga, Kryeministri publikon raportin
863 mijë eurot, prokuroria sekuestron regjistrat e "Kurum" Debatet, Xhafaj: Po hetojmë

Zyrtari i lartë i SHBA, Yee: Të jemi të prerë me udhëheqësit e korruptuar

Nga INA ALLKANJARI

Prokuroria e Krimeve të Rënda vijon hetimet për biznesmenin Orest Sota në lidhje me burimin e 863 mijë eurove që u gjetën në makinë. Më herët 25-vjeçari ka deklaruar se paratë kishin destinacion ...
Në faqet 2,3,4

DI VARIANTET QE PO DISKUTOHEN NE QEVERI. MINISTRI I FINANCEVE: DY MUJ PER FORMULEN E RE

PENSIONET, SI NDRYSHON SKEMA PER PERFITUESIT

Debatet në Komisionin e Ekonomisë, Braçe: Reforma e pensioneve në fshat nuk po funksionon. Ahmetaj: Të ulim pagën minimale, përderisa nuk paguhen kontribute



(Në foto) Pensionistë (foto ilustruese). Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj



Në faqen 9

BUXHETI 2018

Dëmshpërblim për 5400 ish-të përndjekur, 4 mld lekë për pronarët

Në faqen 8

VRASJA NË ITALI

Shqiptari masakron gruan në sy të djalit 8-vjeçar, motiv xhelozia

Në faqen 16

AKADEMIA E SHKENCAVE

Përplasia me qeverinë, jep dorëheqjen Gudar Beqiraj, takimi me Presidentin

Në faqen 18

LEGALIZIMET

ALUIZNI, 400 personat që kanë gati lejet e banesave në Korçë

Në faqen 10

QSUT: AFATI I FUNDIT I APLIKIMEVE MË 21 NËNTOR



Shpallen 30 vende të lira pune për infermier, ja cilat janë kriteret

Në faqen 13

Dosier/ Zbulohet korrespondenca "Top sekret" në '89, këngëtarja Eli Fara ndiqej nga Sigurimi i Shtetit

Telefonata nga SHBA: "Do martohem me Eli Farën" që alarmoi Byronë

Raporti i Jorgo Melicës: "Vera Grabocka i ka thënë se problemin e martesës t'ia ngrejë shokut Spiro Dede"

Nga DASHNOR KALOÇI

E dhe pse kishte kaluar Egjysma e dytë e vitit 1989 dhe në mjaft prej shteteve të Europës Lindore kishin filluar të ndiheshin "erërat" që vinin nga përtej Atlantikut, në Shqipërinë komuniste dukej se nuk po frynte e nuk



po lëvizte asgjë dhe "ujerat" rrinin po në vend?! Madje dukej sikur gjërat po shkonin mbrapsht dhe situata po përkeqësohej gjithnjë e më shumë për shkak të gjendjes ekonomike tejet të vështirë që po kalonte vendi, gjë e cila lidhej direkt me...
Në faqet 14-15

DROGA REAGIMET

Deputetët e PD-së i kundërvihen ministrit, Noka: Policia fshehu ngjarjen

Patentat e Tahirit, Xhafaj: Po hetojmë për përgjegjësitë

"Jahti në Durrës? Nuk kontrolloj portet"

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj deklaroi dje se ka ngarkuar Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave për të hetuar ngjarjen ku u arrestua biznesmeni O.S. dhe përgjegjësitë që ka policia në këtë rast. Fatmir Xhafaj mbrojti buxhetin e Ministrisë së Brendshme në Komisionin e Sigurisë Kombëtare në Kuvend. I pyetur nga deputeti i PD-së, Flamur Noka, në lidhje me fshehjen e ngjarjes së Elbasanit, ku u gjetën 863 mijë euro, Fatmir Xhafaj u shpreh se hetimet e SHÇBA do të vlerësojnë mënyrën si është sjellë policia, ndërsa shtoi se e gjithë ngjarja është e regjistruar dhe tashmë përgjegjësinë e ka prokuroria. "Lidhur me ngjarjen e Elbasanit, Policia e Shtetit ka bërë detyrën konform ligjit. Lidhur me shqetësimin e politikës, ka ngarkuar SHÇKB të hetojë për përgjegjësitë që kanë policët në këtë detyrë. Ajo që dua të bëj me dije është që gjithçka ka ndodhur është e regjistruar dhe i është paraqitur prokurorisë. Pak orë më vonë, çështja është filluar nga prokuroria dhe përgjegjëse është prokuroria. Ajo përcakton nëse ka shkelje nga policët në këtë ngjarje", deklaroi ai. Në fund pas debateve, deputetët e PD-së në Komisionin e Sigurisë janë larguar nga mbledhja përpara votimit. Ministri Xhafaj shpjegoi për deputetët se agjentët e FBI-së, por edhe ekspertët nga Italia dhe Gjermania do të paguhën nga qeveritë e vendeve të tyre. "Ekspertët e FBI, Gjermanisë dhe të Italisë do të paguhën nga qeveritë e vendeve respektive. Ne krijojmë kushtet dhe stafin që u shërbejnë. Stafit është nga Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme, nëse do të jetë e nevojshme për burime shtesë, do i kërkoj qeverisë për të nxjerrë buxhet. Aktualisht janë akomoduar ekspertët e FBI, do vijmë edhe të tjerë, ka filluar punë edhe eksperti nga Gjermania,



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

EBATET NË KOMISIONIN E SIGURISË

FLAMUR NOKA: Kam disa pyetje. Pse nuk është Haki Çako në prezantimin e buxhetit? Policia që ju drejtoni, a është policia që duam? Para disa ditësh u hoq një minijakt pasi skandaloi i Tahirit. I kujt ishte? A mund të na bëni një koment për fshehjen nga policia të skandalit të Elbasanit, ku u gjetën 863 mijë euro dhe tri patentat? Ju do merrni patentë skali, se qeveria e rilindjes e ka bërë traditë?
FATMIR XHAFAJ: Nuk është gjykar e arsyeshme që Çako të jetë këtu. Mbrojtja e buxhetit është përgjegjësi e imja kushtetuese dhe ligjore. Unë jam këtu për të mbrojtur buxhetin dhe jo për t'u mbrojtur nga policët. Unë nuk drejtoj policinë, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm. Unë jam ministër i Brendshëm. Unë nuk kontrolloj territoret e porteve dhe nuk marr informacion sa kohë janë informacione policore. Vetëm kur kërkohet të më jepet për shkak të detyrës. Lidhur me ngjarjen e Elbasanit, Policia e Shtetit ka bërë detyrën konform ligjit. Lidhur me shqetësimin e politikës, ka ngarkuar SHÇKB të hetojë për përgjegjësitë që kanë policët në këtë detyrë. Ajo që dua të bëj me dije është që gjithçka ka ndodhur është e regjistruar dhe i është paraqitur prokurorisë. Pak orë më vonë, çështja është filluar nga prokuroria dhe përgjegjëse është prokuroria. Ajo përcakton nëse ka shkelje nga policët në këtë ngjarje. Unë nuk e kam këtë tagër që të tejkaloj kompetencat e policisë dhe aq më tepër ato të prokurorisë.
ENDRIT BRAHILLARI: Ke shkarkuar të gjithë drejtuesit, por jo Haki Çakon...
FATMIR XHAFAJ: Nuk mund të shkarkoj drejtorin e policisë, sepse ka shqetësim në forcë politike.
ENDRIT BRAHILLARI: Por nëse ka shkelje në funksion të detyrës?
FATMIR XHAFAJ: Unë nuk e kam këtë shqetësim.
SALIANJI: Ju thate se nuk e shkarkoj drejtorin nga shqetësimet tuaja, ju thate se performanca nuk matet nga shqetësimet politike, por harroni se ai tip që ju kemi aty, në pjesën më të madhe janë ekipi i ish- ministrit të Brendshëm, që sot duhet të ishte në burg, por ju e mbajtët në kurriz, duke mos ia dorëzuar policisë dhe sot e gjithë ditën janë kapur tonelata me drogë në Itali, por nuk shihen. Ju flisni sikur jeni ministër për rregullimin e fasadave, këto i ka bërë më mirë paraardhësi juaj, se merrte 5 mln euro në muaj nga krimi. Nuk është çështje bojatisjeje dhe as e marrjes me qetësi sikur nuk po ndodh gjë, është çështje e vullnitet politik, ju kemi vetëm seriozitetin në fjalë, ndryshe nga ministri i mëparshëm. Ti je njësoj si Tahiri. Nuk ke marrë asnjë masë për tonelatat me drogë dhe lidhja e qeverisë me krimin vazhdon.
FELAJ: Asnjë fjalë për buxhetin, qeverisja ka filluar dhe ka shprehur vullnet të plotë në luftën kundër krimin, ishim mbledhur për buxhetin.
XHAFAJ: Të jem i singërt, nuk i futem sa tonelata janë kapur, nuk do ishte e dobishme, nuk jam për të parë çfarë ka ndodhur, por për të bërë çfarë duhet bërë. Nëse ju thoni se nuk pajtohem me shumë gjëra, edhe më tonalitetin dhe gjunhin, pata mirësinë t'ju dëgjoj, nëse e marr me qetësi a nervozizëm po jam shumë i qetë, por me përgjegjësinë që më njih Kushtetuta. Termini bandë në Policinë e Shtetit nuk është i duhuri, ju sugjeroj se ky lloj termi nuk është i përshatshëm, nëse do thoni që ka njerëz që nuk e meritojnë të jenë pjesë, e kam thënë dhe jam duke vepruar.
NOKA: Ka bandë ata, ka banditë.
MYSLIM MURRIZI: Kur thua s'ka banditë në Policinë e Shtetit, përse i shkarkove 12 drejtorët e policive të qarkut? Se nëse nuk kishit indicie nuk i shkarkonit, kot se ndryshe ju hedhin në gjyq dhe ju marrin paratë ata.

MINISTRI BRITANIK
 Ministri i shtetit britanik për Evropën dhe Amerikën, Sir Alan Duncan deklaroi dje se, "po e vëzhgojmë çështjen 'Tahiri', por nuk përfshihemi". Gjatë një interviste për "Ora News", Sir Alan Duncan u shpreh: "Sigurisht që jam i informuar për akuzat, për zhvillimet, por kjo është një çështje e sistemit të drejtësisë shqiptare, shtetit tuaj të së drejtës. Sigurisht në vëzhgojmë, por nuk na takon në të përfshihemi dhe t'ju tregojmë se çfarë duhet të bëni".



Foto ilustruese

MASA E ARRESTIT

Burg për "financierin" e Habilajve Prokuroria: U përgjua në pazare droge

Gjykata e Krimeve të Rënda ndryshoi masën nga 20 ditë burg, në arrest me burg për Nezar Seitin, i pranësor për llogari të hetimeve italo-shqiptare ndaj një grupi që trafikonte kanabis. Gjatë këtyre ditëve i riu përmes avokatit të tij synoi të ekstradohej në Itali, pasi pretendon pajësinë. Por, pasi u realizua përkthimi i dosjes, prokurorët konfirmuan edhe njëherë në gjykatë qëndrimin e tyre, me pretendimin se Seiti shfaqet në përgjimet e italianëve duke biseduar me shtetasin Moisi Habilaj. Përgjimet ambientale janë zhvilluar pas 2014-ës në disa automjete me të cilat të dyshuarit udhëtonin në jug të Italisë. Habilaj del në përgjime në një pjesë të grupit të goditur në 2012 gjatë aksionit "Odesa", tha prokurori, ndërkohë që deri në 2014-ën në Sicili dhe Katania italianët kanë drejtuar edhe katër aksione të tjera antidrogë, duke sekuestruar sasi të ndryshme hashashi.



PD dhe LSI, Metës: Deklasifiko diskutimet për drogën në Këshill

Deputetët e PD-së dhe LSI-së i kërkojnë Presidentit Ilir Meta që të deklasifikojë dhe të publikojë informacionet dhe diskutimet e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare së një viti më parë, në 11 nëntor të vitit 2016 për kanabisin. Kërkesa është firmosur nga 7 deputetë të Partisë Demokratike dhe të LSI: Flamur Noka, Myslim Murrizi, Endrit Brahillari, Isuf Çelaj, Ervin Saliq dhe Xhemal Gjunkshi dhe Luan Rama. Në këtë mbledhje është raportuar për situatën e kanabisit, ndërsa i pranishëm ka qenë edhe ish-ministri Tahiri, që sot është i akuzuar nga prokuroria për përfshirje në dosjen "Habilaj". Në atë kohë mbledhja u drejtua nga presidenti Bujar Nishani, ndërsa deputetët e PD-së pohojnë se janë dhënë detaje për implikimin e zyrtarëve të Policisë së Shtetit. Në mbledhje raportoi edhe SHISH dhe institucione të tjera.



Kryeministri publikon statistikat e kultivimit të kanabisit në Shqipëri

Raporti për hashashin, Rama: Ta lexojë kush sheh me sytë e vet

"Berisha tha se ishte vendimi i tij për të mos ndërhyrë në Lazarat"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama publikoi dje, raportin analitik të kultivimit të kanabisit në Shqipëri. Sipas këtij raporti, "Në vitin 2017, plot 23.77 për qind e sipërfaqes territoriale shqiptare ka qenë në objektivin e monitorimit, me një rritje prej 40 për qind më shumë se viti 2016". Përballja e fuqishme me organizatat kriminale përgjatë 4-vjeçarit 2013-2016, sipas këtij raporti, i ka dëmtuar rëndë ato organizata që merren me prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike. Bashkëngjitur raportit, kryeministri Edi Rama deklaroi, në rrjetin social "Facebook" se "Kush sheh me sytë e vet dhe lexon me mendjen e vet, le ta lexojë! Ata që shohin me gojën e kazanëve dhe mendojnë me kokën e politikaneve e analistëve të kazanëve, mos ta marrin fare mundimin!". Në raport thuhet se për vitin 2017, nga Guardia di Finanza janë kryer 30% fluturime më shumë se vitin e kaluar nga 106 në 29 orë fluturimi. Sipas këtij raporti, "Policia e Shtetit organizoi dhe finalizoi me sukses operacionet "Lazarati" dhe "Dukagjini" për goditjen e veprimtarisë dhe rrjeteve kriminale të kultivimit të bimëve narkotike". Miratimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, sipas këtij raporti, "ka luajtur një rol vendimtar për arritjen e rezultateve të deritanishme dhe ka qenë një nga masat më të rëndësishme me karakter ligjor e institucional". Në përmbledhjen që i bëhet raportit, thuhet: "Mbjellja e kanabisit ka filluar në vitet 1991-1992. Në këtë kohë kultivimi apo trafikimi nuk ishin të parashikuara si vepra penale dhe për rrjedhojë, lufta kundër këtij fenomeni, nuk kishte baza të mirëfillta normative. Me parashikimin e kultivimit si veprë penale në 1996 filloi edhe dokumentimi i këtij fenomeni në statistikat zyrtare. Në dhjetë vitet në vijim konstatohet se fenomeni kriminal evoluoi me një shpejtësi më të madhe, se sa reagimi i agjencive ligjbatuese. Në vitet 2002-2004 Shqipëria filloi të miratojë aktet dhe strukturat e para për luftën ndaj këtij fenomeni kriminal. Pas vitit 2013, qeveria shqiptare e futi luftën kundër



MONITORIMI

Në vitin 2017, plot 23.77% e sipërfaqes territoriale shqiptare ka qenë në objektivin e monitorimit, me një rritje prej 40% më shumë se viti 2016.

I akuzoi vëllain, Ndreu-Berishës: Shiko veten dhe pjellat e tua

Deputeti i Partisë Socialiste, Pjerin Ndreu me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook" i është kundërpërgjigjur ish-kryeministrit Sali Berisha, në lidhje me akuzat e bëra në adresë të vëllait, Paulin Ndreu, ku sipas Berishës ai ka pajisur me patentë Saimir Tahirin. Deputeti Ndreu shkruan se akuzat të adresuara për vëllain e tij, se pajisi me patentë ish-ministrin e Brendshëm, janë një agresion i pashembullt, i dirigjuar nga Berisha dhe derivatet e tij. Ndreu tha se kjo që po ndodh është një kopje e neveritshme e ndërmarrë këto ditë ndaj meje dhe vëllezërve të mi. "Sali, shiko veten dhe pjellat e tua se ke kusure për të larë në këtë vend bashkë me ata bubur-recët që bëjnë si të fortë që ke rrotull teje! Unë, familja ime, vëllezërit e mi dhe kushërinjtë deri në 5 brez, nga nëna e babai e bëjmë gjumin rehat, se nuk i kemi borxh asnjë njeriu në këtë botë dhe as ligjit"-shkruan ai.

Projekti "1 miliardë për rindërtim"

Rama: Ndëshkim për supervizorët mashtrues

Kreu i qeverisë paralajmëroi dje ndëshkim për të gjithë ata supervizorë që mashtrojnë për të përfutur nga buxheti i shtetit. "Tolerancë 0 ndaj supervizorëve që do mashtrojnë për të përfutur nga buxheti i shtetit. S'ka zyrtar ARRSH të hapë buxhet me firmën e tij duke i hapur borxhe qeverisë e më pas popullit, duke bërë sikur s'kupton. Ne besojmë se i kemi të gjitha potencialet për këtë financim masiv, duke krijuar vende pune, duke stimuluar ekonominë e në fund të 4-vjeçarit të kemi vepra të përfunduara," u shpreh kreu i qeverisë. Kryeministri Edi Rama gjatë dëgjësjes publike në rrethimin 2018 për infrastrukturën foli për programin "1 miliard për rindërtim" ku e vuri theksin në përfundimin e disa prej akteve kryesore të vendit. Kreu i qeverisë tha se në këtë 4-vjeçar qeveria do të bëjë të mundur transformimin e akteve për t'u certifikuar sipas standarteve europiane, për të garantuar lëvizshmërinë e sigurtë. "Ne jemi një vend ku nuk është financiar pak për infrastrukturën kombëtare, dhe nëse do vendosim në balancë paratë e derdhura me rezultat në vitet, ka hendek të madh. Planifikimi kombëtar dhe projektet kanë qenë në të mangëta. Dhe në fund produkti është i mangët. Sot nuk kemi asnjë rrugë kombëtare të certifikuar sipas standarteve europiane. Në këtë 4-vjeçar do bëjmë të mundur këtë transformim, që akset tona të garantojnë lëvizshmëri e që nuk kërcënojnë jetën e askujt. Si do bëhet kjo? Kemi një buxhet për vitin e ardhshëm, 42% më i lartë për financimin e infrastrukturës, do të jetë i mjaftueshëm nëse projektet janë të duhurat" tha Rama.

• Në vitin 2015, përgjatë 39 misionesh fluturuese, u zbuluan 1.368 plantacione kanabisi, për një total prej 242.945 bimë narkotike, mandej të asgjësuara;

Në 2017-n, në kuadrin e 53 misionesh fluturuese nën mbulim italian, me një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet mbraja, janë zbuluar 88 plantacione, për një total prej 4.844 bimë të asgjësuara. Përtej këtyre misionesh telerilevuesh, nga mesi i shtatorit deri në 5 tetor 2017, janë kryer nga ana e Guardia di Finanza 5 misione fluturuese të tjera nën mbulimin financiar të Bashkimit Europian, që kanë mundur të identifikojnë dhe 2 plantacione në të cilat janë zbuluar dhe asgjësuar 473 bimë kanabisi.

• Në vitin 2016, vit rekord nëse flasim për rezultate operative, në kuadrin e 42 misionesh fluturuese, janë zbuluar 2.086 plantacione kanabisi, për një total prej 753.468 bimë të asgjësuara.



VITET	2015	2016	2017
Misione fluturuese	39	42	53
Plantacione zbuluar	1.368	2.086	88
Bimë narkotike zbuluar	242.945	753.468	4.844

Në vitin 2017, plot 23.77% e sipërfaqes territoriale shqiptare ka qenë në objektivin e monitorimit, me një rritje prej 40% më shumë se viti 2016

Si vërtetim i rezultateve gjithmonë e më të dukshme të shërbimit, nga 2012-a e deri më sot, është rritur fort numri i misionesh të fluturimit, duke kaluar nga 25 të 2013-s në 53 misione fluturimi me mbulim financiar italian (të cilëve u janë shtuar mandej 5 me mbulim financiar nga Bashkimi Europian), të kryera përgjatë këtij viti të fundit. Më në detaj, pas fazës së parë eksperimentuese të nisur përgjatë vitit 2012:

Faksimile e raportit analitik të kultivimit të kanabisit në Shqipëri

kanabisit në nja fazë të re. Në vitin 2014 dhe 2015 ndërmori operacione dhe masa konkrete për të luftuar kultivimin e kanabisit në zonat e përmendura të Lazaratit dhe Dukagjinit. Gjithsesi, citon raportin në vitin 2017, qeveria shqiptare rinovoi impemjimin për të goditur drastikisht fenomenin e kultivimit të kanabisit, duke bërë arrihtjen e një rezultati më të suksesshëm në 25 vjet. Viti 2017 dëshmoi se kultivimi i kanabisit në Shqipëri është një betejë që fitohet. Goditja e fenomenit të kultivimit të kanabisit i hap rrugë një faze tjetër më të rëndësishme dhe të vështirë: përballjes me krimin e organizuar, me grupet kriminale që kanë financuar dhe organizuar këtë veprimtari kriminale. Policia e Shtetit, në bashkëpunim e ndërveprim me agjencitë e tjera ligjbatuese, kanë nisur një operacion konkret për zbulimin, gjurmimin, procedimin penal dhe ndëshkimin e grupeve kriminale të përfshira në kultivimin dhe trafikimin e kanabisit si dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve të krijuara si rrjedhojë e kësaj veprimtari kriminale. Në këtë raport citohet edhe një deklaratë e ish-kryeministrit Berisha: "Në një deklaratë të datës 19 qershor 2014, ish-kryeministri i Shqipërisë në vitet 2005-2013, z. Sali Berisha, deklaronte se për të mos ndërhyrë në Lazarat "...ishite vendimi i tij politik dhe pikë!"

BIZNESMENI HETIMET

Detaje e hetimit të biznesmenit, Prokuroria çon lekët në bankë

863 mijë eurot në makinën e Sotës, sekuestro rregjistrave të "Kurum"

Pritet të pyeten edhe ish-ministri Tahiri e shoferi

Ina Allkanjari

Prokuroria e Krimeve të Rënda vijon hetimet për biznesmenin Orest Sota në lidhje me burimin e 863 mijë eurove që iu gjetën në makinë. Më herët 25-vjeçari ka deklaruar se paratë kishin destinacion kompaninë "Kurum" për një pagesë hekur. Në vazhdimësi të hetimit, prokuroria ka sekuestruar regjistrat e shitblerjes pranë kompanisë së çelikut "Kurum" në Elbasan. Prokuroria i kërkon kësaj kompanie një sërë dokumentesh për transakcionet me shoqërinë "Ikona", që përfaqësohet nga Lefter Sota, i ati i Orest Sotës, deklaroi "Report TV". "Ikona" dhe "Kurum" rezultojnë të kenë pasur marrëdhënie financiare, por përmes bankave. Për shkak se dëshmitarë të kompanisë "Kurum" kanë deklaruar se nuk pranojnë para kesh për hekur, dhe aq më pak një shumë të tillë të konsiderueshme, prokuroria dyshon për pretendimet e ngritura nga Orest Sota. Synimi i organit të akuzës është të kontrollohet e gjithë praktika e shitjeve të kësaj kompanie, për të mësuar nëse i arrestuar Orest Sota dhe babai i tij Lefter Sota, kanë blerë hekur në këtë kompani dhe nëse kanë detyrime financiare ndaj "Kurumit". Më herët babai i Sotës ka pretenduar se sasia e eurove i përket atij, por ai ende nuk është paraqitur në prokurori për të venë në dispozicion dosjen me pretendimet e tij. Prokuroria e Krimeve të Rënda nuk e ka thirrur ende biznesmenin Lefter Sota, i cili argumenton se shuma do të lihej si garanci për blerjen e 4 mijë tonëve hekur. Aktualisht prokuroria po verifikon pasuritë e Orestit, sa informacioneve se njëra nga banesat e tij gjendet në të njëjtën ndërtesë ku jeton edhe ish-ministri i Brendshëm. Ndërkohë hetimi penal për biznesmenin Orest Sota pritet t'i bashkëngjitet dosjes së Saimir Tahirit.

HETIMI

Mësohet se prokurorët, bazuar në një udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm, kanë vendosur të mbyllin në



Biznesmeni Orest Sota

HETIMET

Prokuroria ka sekuestruar regjistrat e shitblerjes pranë kompanisë së çelikut "Kurum" në Elbasan. Prokuroria i kërkon kësaj kompanie një sërë dokumentesh për transakcionet me shoqërinë "Ikona", që përfaqësohet nga Lefter Sota, i ati i Orest Sotës.



Patentat e Saimir Tahirit që u gjetën në makinën e biznesmenit

Takimet e delegacionit do të vazhdojnë edhe me zyrtarë të tjerë

Çako pret në zyrë përfaqësuesit e FBI-së, lufta kundër krimit të organizuar



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako, dhe me dy përfaqësuesit e FBI-së, Atasheun e FBI/LEGAT Jack Liao dhe Mark Newhouse, agjent special i FBI-së

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako priti dje përfaqësuesit e FBI-së, që do të asistojnë Policinë e Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikëve dhe terrorizmit. Takimi u realizua me dy përfaqësuesit e FBI-së, Atasheun e FBI/LEGAT Jack Liao dhe Mark Newhouse, agjent special i FBI-së, i specializuar për hetimin e krimit të organizuar. Në takim u vlerësua me nota shumë pozitive bashkëpunimi mes FBI-së dhe Policisë së Shtetit në luftën kundër terrorizmit, si dhe lufta kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit e bërë nga Policia e Shtetit këtë vit, duke e cilësuar një histori suksesi. Gjithashtu, u konfirmua vullneti i zyrtarëve amerikanë për të ndihmuar policinë shqiptare kundër krimit të organizuar dhe në mënyrë

specifike kundër krimit financiar, transfertave të paligjshme dhe aseteve të ardhura nga aktivitete kriminale. Drejtori i Përgjithshëm Çako falënderoi zyrtarët e FBI-së dhe u shpreh se eksperiencia e

tyre do të shërbejë për orientim drejt rrugëve më të mira për të goditur dhe vënë përpara përgjegjësisë grupet e strukturuar kriminale. Më pas zyrtarët e FBI-së janë takuar me Drejtorin e Departamentit

BASHKËPUNIMI

Në takim u konfirmua vullneti i zyrtarëve amerikanë për të ndihmuar policinë shqiptare kundër krimit të organizuar dhe në mënyrë specifike kundër krimit financiar, transfertave të paligjshme dhe aseteve të ardhura nga aktivitete kriminale.


për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, Idajet Faskaj. Takimet e këtij delegacioni do të vazhdojnë gjatë ditëve të ardhshme edhe me zyrtarë të tjerë të shtetit shqiptar.

përfunduar në makinën e Orestit Sotës tre patentat e Saimir Tahirit dhe bashkëshortes së tij, prokuroria pritet të pyesë ish-ministrin e Brendshëm Tahiri dhe shoferin e tij Gentian Cekën. Prokuroria do verifikojë ditën e 1 dhe 2 nëntorit nëse Gentian Ceka ka qenë në detyrë pranë Gardës së Republikës, apo jo.

Kryeprokurori i Roterdamit:

Shqiptarët zotër të drogës në Holandë

Shqiptarët janë kthyer në zotër të trafikut të drogës në Holandë dhe kontrollojnë portin më të madh në Europë. Shqetësimin për rritjen e kriminalitetit shqiptar në vendin e Bashkimit Evropian e ngre kryeprokurori i Roterdamit, Marc van Nimwegen. Kryeprokurori shprehet se rrjetet e organizuara kriminale të shqiptarëve kanë arritur të kontrollojnë pikat kyçe në importimin e kokainës. "Më lejoni së pari t'ju them se Roterdami është një qytet multinacional dhe ne kemi një nga portet kryesore të botës. Është një port gjigand me logjistikë të madhe dhe, gjithashtu, përdoret nga kriminelët për trafikë ilegale. Vitet e fundit kemi parë se disa rrjete fluide të kriminalitetit shqiptar kanë arritur të sigurojnë pozicion shumë të fortë e rëndësishëm në portin e Roterdamit. Fillimisht ata ishin në Belgjikë në Antwerpen dhe tashmë kanë arritur një pozicion ekonomik të paligjshëm në portin e Roterdamit. Ata duket se janë të aftë të kontrollojnë pikat e tyre në importimin e kokainës nga Amerika e Jugut në Roterdam dhe më pas nga Roterdam duke furnizuar Europën", deklaroi Nimwegen.



Zyrtari amerikan, Yee: Shqipëria të nisë 'drejtësinë', atëherë do jemi të kënaqur

SHBA: Jemi të prerë me udhëheqësit e korrumpuar

"Qeveria të mbajë zotimet, jo reforma të pjesshme"

Valentina Madani

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i dërguan dje një mesazh të qartë Tiranës zyrtare se duhet të vënë pas hekurave të gjithë politikanët e korrumpuar dhe të lidhur me krimin e organizuar. Zv/ndihmës sekretari amerikan i Shtetit Hoyt Yee, i angazhuar nga afër së fundmi me Ballkanin Perëndimor, apeloj se Perëndimi duhet të tregohet më i prerë ndaj udhëheqësve të akuzuar për shkelje apo korrupsion në vendet e rajonit.

"Është për të ardhur turp se si udhëheqës politik të Ballkanit, pavarësisht nga akte të dënueshme, mirëpritën në shumë kryeqytete evropiane, sikur aktet e tyre nuk përbëjnë asgjë të keqe. Kur qytetet e këtyre vendeve i shohin udhëheqësit e tyre në takime të nivelit të lartë në Evropë dhe Uashington, ata nxjerrin përfundime. Nëse këta udhëheqës nuk lejohen në takime dhe qarqe të caktuara dhe bëhen të qarta arsye përse, kjo do të kishte një ndikim pozitiv në zhvillimet e këtyre vendeve", - deklaroi Sekretari Amerikan i Shtetit Hoyt Yee. Lidhur me reformat në drejtësi që po ndërmerr Shqipëria, diplomati i lartë shprehet se ka rëndësi rezultati: "Ne nuk do të kënaqemi si partner i Shqipërisë me një zbatim të pjesshëm ose me mungesë zbatimi, prandaj do të vazhdojmë të kërkojmë nga qeveria, partitë politike, anëtarët e parlamentit, që të mbajnë zotimet për të zbatuar amendamentet. Synimi nuk është që të kënaqen Shtetet e Bashkuara apo Bashkimi Evropian, por vendosja e sundimit të ligjit, arritja e statusit të pavarësisht për gjyqësorin". Pas vizitës së fundit në Ballkan, komentet e zyrtarit të lartë që Serbia nuk mund të ulët në "dy karrige", duke nënkuptuar Perëndimin dhe Rusinë, ngjallën reagime të shumta. Zoti Yee i sqaron edhe një herë komentet e tij. "Me rëndësi për Serbinë është që, nëse vërtetë synimi i saj strategjik është futja në Bashkimin Evropian, atëherë duhet ta ndjekë këtë synim në një formë që nuk le asnjë dyshim mbi aspiratat e saj të vërteta. Ajo nuk duhet të lërë përshtypjen se



Sekretari Amerikan i Shtetit Hoyt Yee

THIRRJA

"Ne nuk do të kënaqemi si partner i Shqipërisë me një zbatim të pjesshëm ose me mungesë zbatimi, prandaj do të vazhdojmë të kërkojmë nga qeveria, partitë politike, anëtarët e parlamentit, që të mbajnë zotimet për të zbatuar amendamentet", - tha z. Yee.

TAKIMI



Koordinimi në Kuvend, Kryemadhi takon Bashën

Kryetarja e LSI, Moni Kryemadhi, e shoqëruar nga kryetari i grupit, Petrit Vasili dhe zhvilloi një takim me krenun e PD-së, Lulzim Bashën për rreth 40 minuta. Në qendër të bisedës ishte aksioni opozitar, një ditë para seancës plenare. Basha dhe Kryemadhi diskutuan për koordinimin e aksionit opozitar, ndërsa një gjë të tillë e pohoi edhe kryetari i PD pas takimit. Sot do të diskutohet në parim projektbuxheti për vitin 2018, por vëmendjen kryesore pritet që ta zërë çështja e Tahirit pas patentave që u gjetën në Elbasan, pasi një gjë të tillë e paralajmëroi edhe Basha para 2 ditësh. Po dje PD dhe LSI u bënë bashkë në Këshillin Bashkiak të Durrësit kundër paketës fiskale 2018. 10 vota ishin kundër kësaj pakete, ndërkohë që 19 vota ishin pro dhe një abstenu.

BASHKËPUNIMI



Williamson: Shqipëria kontribuese në NATO

Në ditën e parë të Minsterialit të Mbrojtjes, që po mbahet në Shtabin e NATO-s në Bruksel, Ministria Olta Xhaçka u takua dje me Sekretarin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, Gavin Williamson. "Vlerësojmë kontributin e Shqipërisë në strukturat e NATO dhe veçanërisht atje ku ne jemi shtet drejtues, siç është rasti i task-forcës së gatishmërisë së lartë. Me lejonin zonja Ministre, t'ju shpreh vlerësimin më të lartë për kontributin tuaj të konsiderueshëm, me gjithë kufizimet buxhetore me të cilat përballemi", - tha Williamson. Në aspektin operacional ai nënvizoi se numri i stërvitjeve të përbashkëta të zhvilluara mes dy vendeve dhe niveli i tyre i kanë shërbyer rritjes së ndërveprimësive dy ushtrive aleate. Sipas zotit Williamson, stërvitja e përbashkët "Albanian Lion", e planifikuar për t'u zhvilluar vitin e ardhshëm në Shqipëri është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim.

"Arrestoni 'peshqit e mëdhenj'"

Ristani: Çdo demokrat të duartrokasë ambasadorin Lu

Sekretari i përgjithshme i Partisë Demokratike, Arben Ristani komentoi dje deklaratën e ambasadorit Donald Lu, sa për këtë thirrjes së tij për arrestimin e 'peshqve të mëdhenj'. Në një status në "Facebook", Ristani thekson se sot është dita që edhe ata që kanë notuar në ujërat e pista të korrupsionit, të kapen nga rrjetat e drejtësisë. Mes të tjerash, ai theksoi se çdo demokrat i ndershëm duhet të duartrokasë deklaratën e ambasadorit Lu. "Unë besoj se sot është dita që jo një peshk i madh, as dy e tre, por të gjithë ata që kanë notuar në ujërat e pista të krimit dhe korrupsionit duhet të kapen nga rrjetat e drejtësisë. Çdo demokrat dhe njeri i ndershëm i këtij vendi duhet të duartrokasë ambasadorin Lu dhe specialistët amerikanë antikrim, për përgatitjet dhe ndihmën ndaj institucioneve ligjzbatuese shqiptare, në mënyrë që për një kohë rekord nga



MBËSHTETJA

"Çdo demokrat dhe njeri i ndershëm i këtij vendi duhet të duartrokasë ambasadorin Lu dhe specialistët amerikanë antikrim, për përgatitjet dhe ndihmën ndaj institucioneve ligjzbatuese shqiptare", tha Ristani.

sot, mundësisht brenda dy muajve, brenda janarit që vjen, të jenë para drejtësisë krerët, ideatorët, frymëzuesit, nxitësit, mbështetësit,

ekzekutorët dhe përfituesit e mëdhenj nga situata kriminale që po i zë frymën Shqipërisë", shkruan z.Ristani në "Facebook".

tërhiqet nga dy forca njëkohësisht: njëra në Lindje, tjetra në Perëndim. Ka rëndësi të pranohet se Rusia ka një vizion krejt tjetër për Ballkanin, përfshirë Serbinë, se sa Perëndimi. Këto vizione nuk përputhen", deklaroi z.Hoyt

Yee. Zyrtari i lartë amerikan shprehet se Kosova dhe Serbia mund të dërgojnë një mesazh të qartë se kanë vullnetin politik për të marrë vendimet e vështira politike që nevojiten për të djathtë, në takimet e ardhshme

mes palëve në kuadër të dialogut dypalësh. Zoti Yee thotë se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të ndihmojnë procesin e dialogut, por shton se përgjegjësia e parë është mes dy qeverive në Beograd dhe Prishtinë.

Debate në komision, deputeti i PS: Unë në anën e shtetit, PD në anën e krimit

Valentina Madani

Debatet e forta për shinë dje Komisionin e Ligjeve, ku po diskutohet buxheti i institucioneve të drejtësisë. Mësohet se që në nisje të mbledhjes, teksta filloi diskutimi për buxhetin, Halimi e ka quajtur të gjithë këtë një alibi. Sipas tij, institucioneve u jepet çfarë kërkojnë që të mos thonë nuk kishim para për të futur kriminelët në burg, ndërsa thekson se ishte gabim sulmi ndaj prokurorisë. Manja i përgjigjet Halimit se nuk i merr leje se çfarë duhet të bëjë. Deputeti i PD-së debatoi me kryetarin Manja, teksta i kërkonte kryetarit të komisionit që mos bëjë 'kamikazin' e kryeministrit Rama. Halimi i tha Manjës se bëri gabim që sulmoi një ditë më parë prokurorinë për çështjen CEZ, duke i kërkuar të mos e neverisë më shumë politikën. "E gjithë kjo është për t'u dhënë institucioneve gjithçka që ata kërkojnë, që mos të kenë alibi që nuk i futëm dot në burg kriminelët se s'kishim fonde. Bëre gabim që sulmova dje (pardje) prokurorinë", deklaroi deputeti i PD-së. Në kundërpërgjigje, Manja theksoi se Halimi është në anën e krimit, ndërsa ai në anën e shtetit, duke shtuar se nuk i merr leje deputetit demokrat se çfarë do bëjë. "S'ka asnjë vlerë, nuk të marr leje ty se çfarë do bëj, këtu jam kryetar, atje jam deputet. Ti ke qenë në anën e krimit, unë në anën e shtetit", u shpreh socialisti Manja. Por, deputeti Halimi iu përgjigj: "Boll e neveritshme është bërë politika, mos e neverit më, me gjithë këto neveri që po dalin çdo ditë. Jemi këtu që të mbështesim institucionet e pavarura që të luftojnë krimin". Deputeti demokrat akuzoi më tej kreun e Komisionit të Ligjeve se po mbron banditët. Nga ana e tij, Ulsi Manja tha: "S'kam mbrojtur kurrë kriminelë. S'kam qenë avokat si ti". Por, i menjëhershëm ishte reagoni i Eduart Halimit: "Më mirë të jesh avokat se të merresh me këtë politikë të neveritshme. Sistemi i drejtësisë është në kolaps. Mungojnë 39 gjyqtarë. Kambanat për kë bien? Kush e do kolapsin? Opozita jo. E do qeveria. Se atë kontrollon drejtësia". Po dje në Komisionin kuvendor të Ligjeve, sekretari i përgjithshëm i prokurorisë, Genti Kosumi, foli para deputetëve mbi buxhetin e institucioneve të drejtësisë, konkretisht organit të akuzës. Kosumi tha se prokuroria kërkon 58 persona shtesë të burimet njerëzore, si dhe 15 sekretarë pranë prokurorisë. "Kërkojmë vetëm 58 persona shtesë tek burimet njerëzore. Të ndarë në: struktura e dekriminalizimit do 6 punonjës, 18 ekspertë kontabël, autoteknikë, vlerësues pasurie dhe krim kibernetik. Kërkojmë 21 psikologë. Duam 17 sekretarë pranë prokurorisë", deklaroi Kosumi. Në këtë moment ndërhyri deputeti socialist, Bashkim Fino, i cili tha se ai po kërkon luks të madh. "Kjo që kërkonte ju është luks i madh. Po bëni avokatit e këtyre, nuk e vrava unë këtë", deklaroi socialisti Fino.

Sherr te Ligjet, Halimi-Manjës: Kamikaz, boll e neverite politikën

Buxheti i prokurorisë, Kosumi: I pamjaftueshëm. Fino: Luks



Komisioni parlamentar i Ligjeve

"ZGJEDHORJA", RUÇI Mbledhjes në Komisionin

Ditën e premte në orën 11:00 do të mbledhet Komisioni i Reformës Zgjedhore. Në këtë mbledhje të parë komisioni do të drejtohet nga kreun e Komisionit, Gramoz Ruçi. Ky komisioni, i cili nis nga puna të premtën drejtohet nga dy bashkëkryetarët, Bledi Çuçi nga mazhoranca dhe Oerd Bylykbaşi nga opozita. Komisioni përbëhet nga 18 anëtarë dhe ka për detyrë hartimin e ndryshimeve të kadrir ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për tri zgjedhjet e fundit të viteve 2013, 2015 dhe 2017, të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet dhe të propozimeve të partive politike, që kanë marrë secila jo më pak se 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvendin.

DEBATI DJE NË KOMISIONIN E LIGJEVE

EDUART HALIMI: E gjithë kjo është për t'u dhënë institucioneve gjithçka që ato kërkojnë, që mos të kenë alibi që nuk i futëm dot në burg kriminelët se s'kishim fonde. Bëre gabim që sulmova dje (pardje) prokurorinë.
ULSI MANJA: S'ka asnjë vlerë, nuk të marr leje ty se çfarë do bëj, këtu jam kryetar, atje jam si deputet.
EDUART HALIMI: S'të lejohet ty si kryetar të bësh 'kamikazin' për kryeministrin.
ULSI MANJA: Vazhdo me buxhetin. Mos e ndërprit fjalën, vazhdo se këtë punë ka ky.
EDUART HALIMI: Në jemi profesionistë të dy.
ULSI MANJA: Ti ke qenë në anën e krimit, unë në anën e shtetit.
EDUART HALIMI: Boll e neveritshme është bërë politika, mos e neverit më, me gjithë këto neveri që po dalin çdo ditë. Jemi këtu që të mbështesim institucionet e pavarura që të luftojnë krimin.
ULSI MANJA: Diskutimi në parim ka përfunduar. Ju atëherë ikët... Kujdes kur më drejtohesh mua!
EDUART HALIMI: Ju mbron banditët.
ULSI MANJA: S'kam mbrojtur kurrë kriminelë. S'kam qenë avokat si ti.
EDUART HALIMI: Më mirë të jesh avokat se të merresh me këtë politikë të neveritshme. Sistemi i drejtësisë është në kolaps. Mungojnë 39 gjyqtarë. Kambanat për kë bien? Kush e do kolapsin? Opozita jo. E do qeveria. Se atë kontrollon drejtësia.
GENTI KOSUMI: Kërkojmë vetëm 58 persona shtesë tek burimet njerëzore. Të ndarë në: struktura e dekriminalizimit do 6 punonjës, 18 ekspertë kontabël, autoteknikë, vlerësues pasurie dhe krim kibernetik.
BASHKIM FINO: Kjo që kërkonte ju është luks i madh. Po bëni avokatit e këtyre, nuk e vrava unë këtë.
GENTI KOSUMI: Kërkojmë 21 psikologë.
GENT STRAZIMIRI: Duhet vrarë në fakt, se janë sjellë keq.
GENTI KOSUMI: Duam 17 sekretarë pranë prokurorisë.

Debate në komision, Bumçi: Qeveria dështoi!

Bushati: Plan ambicioz për të luftuar krimin

Krimi i organizuar është bërë shkak për debate të forta edhe te Komisioni i Integritimit. Deputeti demokrat, Aldo Bumçi, është përplasur me ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati, teksta e ka pyetur këtë të fundit për ndikimin e krimit dhe trafikun në procesin e integritimit. Më tej, ai ka përmendur dhe raportet e huaja dhe ardhjen e ekspertëve të huaj, që sipas tij, tregojnë rritjen e krimit në vend. Nga ana e tij, ministri Bushati deklaroi se qeveria ka një plan ambicioz për të luftuar krimin, duke kërkuar dhe bashkëpunimin e vendeve dhe agjencive serioze. Deputeti i PD-së, Aldo Bumçi shtroi pyetjen: "Sa ndikon krimi dhe trafiku në procesin e integritimit? Raportet e huaja tregojnë për rritjen e krimit. Edhe fakti që vijnë ekspertë të huaj tregojnë shqetësimin e vendeve tjera. Shqipëria është baza në rajon e



krimit të organizuar, ju keni dështuar". Ministri Bushati u përgjigj: "Krimi i organizuar nuk ka kufij. Ndërkohë krimi është aq i sofistikuar. Qeveria ka një plan ambicioz për të luftuar krimin. Kemi kërkuar bashkëpunimin e vendeve dhe agjencive serioze për të luftuar krimin".

DEBATI I PLOTË NË KOMISIONIN E JASHTËM

Tritan Shehu: Ka shtim taksash për qytetarët. Të taksojmë dhe ajrin, dhe mbyllim gropat në buxhetin e shtetit.
 Ditmir Bushati: 17% është rritja e buxhetit për Ministrinë e Jashtme
 Mimi Kodheli: Buxheti 2018, a është i mjaftueshëm për zërin e regjistrimit të shqiptarëve jashtë atdheut?
 Edi Paloka: Ai ka numëruar pusët, nuk numëron dot fushat me kanabis...ambasadorët flasin për peshqit e mëdhenj
 Mimi Kodheli: Respektoni komisionin
 Klevis Balliu: Ministri i përgjigjet pyetjes. Lëre se çfarë ka bërë ai në 2015, apo ditë më parë. Shkoi në Kakavijë jo si ministër, por si teknik kompjuterësh
 Ditmir Bushati: E kuptoj shqetësimin e komisionit, por unë e dua opozitën... aq shumë e dua, sa që më dhimbset për nivelin e përfaqësimit. Për çfarë do të flasësh, për marrëveshjen e detit, që e bëtë aq bukur?
 Tritan Shehu: Avash, se po e kaloni cakun.
 Ditmir Bushati: Mbylli veshët nëse nuk do të dëgjosh.
 Futeni kokën si struci
 Tritan Shehu: Mos e prishni mbledhjen...Frikë nga FBI duhet të kenë ata që e mbushën vendin me kanabis. Duhet të votojmë kundër këtij buxheti

'CEZ', Balla: S'mund të mbyllet, politikanët që duhen hetuar

Kreun e deputetëve socialistë, Taulant Balla riktheu dje në vëmendjen çështjen "CEZ" që sipas tij po mbyllet nga prokuroria. Ndërsa e vë gishtin te prokurorët, ai përmend 10 emra njerëzish të njohur që kanë lidhje me atë që e quan skandalin më të madh në 27 vjet. Nga ish-kryeministri Berisha, te djalli i tij, ministra e drejtorë, duhet të hetohen sipas Ballës. "Si u mbyllka dosja pa u hetuar Sali Berisha, Nue Nik Kalaj, Genc Ruli, Ridvan Bode, Florion Mima, Eno Bodo, Ledina Mandjaja ish-avokate e shtetit, Shkëlzen Berisha, Bujar Nepravishta drejtori i ERE, Sokol Ramadani", u shpreh ai. Ndërsa kërkonte hetim të drejtë, në fund të fjalës së tij, ai nuk kurseu të thoshte se pikërisht këta janë "peshq të mëdhenj". "Doni peshq të mëdhenj, ja ku i keni", u shpreh deputeti socialist.

Genc Tafili i dënuar me 25 vite burg për vrasjen e Arben Zylyftarit

Lirimi i vëllait të Admir Tafilit, KLD nis verifikimin

Prokuroria: Hetim gjyqtares Enkeleda Hoxha

Këshilli i Lartë i Drejtësisë nisi dje procedurën për verifikimin e vendimit të gjykatës së Krujës, e cila të martën liroi nga burgu Genc Tafilin, vëllain e Admir Tafilit. Vendimi për lirimin e tij është dhënë ditën martë nga gjyqtarja e gjykatës së Krujës Enkeleda Hoxha, pasi Tafili kreu 17 vite burg. Genc Tafili me vëllanë, Admir Tafilin akuzohen dhe u dënuan për vrasjen e komisarit të policisë Arben Zylyftarit. Genc Tafili është i dënuar me 25 vite burg për vrasjen e Arben Zylyftarit në vitin 2000 gjatë një shkëmbimi zjarri, ku humbi jetën edhe babai i vëllezërve Tafili, Bahri Tafili. Prokuroria e cilësoi vendimin në kundërshtim të hapur me ligjin. Sipas organit të akuzës, ligji e parashikon që nga lirimi me kusht nuk mund të përfitojnë personat e dënuar për veprën penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", veprë për të cilën ishte dënuar dhe Tafili. Por gjykata e Krujës nuk e ka marrë parasysht këtë fakt dhe ka urdhëruar lirimin e tij. Menjëherë vendimi është apeluar dhe i është kërkuar kreu të KLD-së të nisë verifikimin për këtë rast. Vëllezërit Tafili janë të njohur për drejtësinë shqiptare. Pas ngjarjes së vitit 2000, ku veç Arben Zylyftarit mbeti i vrarë dhe Bahri Tafili, babai i Genc dhe Admir Tafilit, ky i fundit nisi hakmarrjen, pasi sipas tij, shkaktoi për vrasjen e babait ishte shefi i Krimeve në policinë e Shkodrës, Prelë Pjetrush. Admir Tafili arriti t'i bëjë një atentat Pjetrushit në Malësinë e Madhe, por fatmirësisht ai arriti të shpëtonte dhe u largua nga Shqipëria. Edhe pse i arrestuar, Admir Tafili më 2 tetor të vitit 2010 mori 5 ditë leje për të takuar familjarët. Ai arriti t'u largohej gardianëve dhe pas 6 muajve në arrati, më 18 mars 2011 qëlloi për vdekje dy vëllezërit e ish-shefit të krimeve, Nik dhe Gjovalin Pjetrush.



Genc Tafili



Fqinjët: Prej kohësh asnjë lëvizje në banesën

Pas lirimit të Genc Tafilit, shtëpia në Shkodër e kyçur

SHKODËR. Pas lirimit nga gjykata e Krujës "News24" dhe "GSH" kanë qenë në banesën e Genc Tafilit në lagjen "Ndocaç" në Shkodër. Banesa qëndron e mbyllur dhe ka dalë në shitje prej vitesh. Familja Tafili është zhvendosur nga qyteti prej filesave të problemeve me familjen Pjetrush. Por edhe të tjerë. Në lagjen Ndocaç banesa është e kyçur, familja është zhvendosur prej kohësh pas problemeve dhe është nxjerrë në shitje. Dera e ndërtesës është e kyçur me një dry të vjetër dhe të ndryshkur. Fqinjët janë tepër të rezervuar për të folur para kamerave, por larg saj pohojnë se prej kohësh nuk kanë parë asnjë lëvizje në banesën e Tafilajve. Sipas tyre familja është larguar në Tiranë dhe në shtëpinë e vjetër nuk jeton me askush. Lajmi për lirimin nga burgu të Genc Tafilit, natyrisht që iu ka bërë përshtypje. Duke mos dashur të mbajnë kontakte asnjë prej banorëve nuk ka komu-



Shtëpia në Shkodër e Genc Tafilit

nikuar me fqinjët e zhvendosur. Teksa i kishin mbetur edhe 3 vite burg, gjykata e Krujës liroi me kusht Genc Tafilin, i dënuar me 25 vite burgim për bashkëpunim në vrasjen e kolonel Arben Zylyftarit në vitin 2000. Në atë kohe policia e Shkodrës organizoi një operacion për arrestimin e Bahri Tafilit, babait të vëllezërve Genc dhe Admir Tafili. Në një shkëm-

bim zjarri gjatë operacionit u vra i kërkua, por edhe drejtori i policisë Arben Zylyftari. Pas ngjarjes që futi në konflikt dy familjet, në vitin 2001 Admir Tafili kreu një atentat, mbi shefin e krimeve të Malësisë së Madhe, Prelë Pjetrush. Por ky i fundit arriti të mbijetojë.

Duke u ndier i kërcënuar, ai u detyrua të largohet në SHBA. Në lidhje me këtë ngjarje, në vitin 2002 policia arrestoi Admir Tafilin, i cili u dërgua në burgun e Shën Kollit për të vuajtur dënimin. Në fundin e shtatorit 2010, Prelë Pjetrush i erdhi nga SHBA në Shqipëri për të parë prindërit dhe vëllezërit e tij dhe lajmi shkoi deri në burgun e Shën Kollit. Admir Tafili u arratis nga ky burg, por Pjetrush u largua menjëherë nga Shqipëria sapo mësoi se personi që i kishin bërë atentat edhe më parë ishte i lirë. Pak muaj më vonë Admir Tafili ende i arratisur, ekzekutoi në shenjë hakmarrjeje 2 vëllezërit e Prelës, Nik e Gjovalin Pjetrush.

SHKURT

Tiranë, iu gjet një pushkë e një automatik, në pranga 45-vjeçari

Një 45-vjeçar, i identifikuar nga policia si Edmond Memaga është arrestuar ditën e djeshme në Tiranë, pasi iu sekuestruan dy armë luftarake dhe municion. Sipas policisë Memaga kishte si qëllim kalimin e tyre në shtrirë fqinjë Greqi. Arrestimi i tij u bë në një rrugë të fshatit Petrelë ku gjeti një pushkë model 56, një automatik model 56, 2 krehër fishekësh dhe 150 copë fishek model 56. Gjithashtu, nga kontrolli i banesës, iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 480 copë fishekësh model 56, 125 copë fishekësh të tjerë dhe 3 thika. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe "Prodhim, mbajtje, blerje apo shitje pa leje e armëve të ftohta".

U kapën duke shitur heroinë në Itali,

në pranga dy shqiptarë
ITALI. Tre persona kanë rënë në prangat e policisë së Venecias, pasi u kapën me 1 kg heroinë në pastër. Mediat italiane raportojnë se bëhet fjalë për dy shqiptarë: Olgert Shati, Sokol Bezhani, të dy nga 25 vjeç, si dhe një tunizian, Tababi Aboutaleb, 23 vjeç. Shqiptarët u kapën në momentin kur po i dorëzonin mallin tunizian, ku ky i fundit tentoi të largohej, por pa sukses. 'Ansa' shkruan se vlera e drogës, nëse do të dilte në treg, ishte 14 mijë euro. Gjatë kontrollit, policia gjeti në mjetin e shqiptarëve edhe një vajzë rumune, e cila po hetohet në gjendje të lirë. Sakaq, karabinierët po heton lidhur me faktin nëse dy shqiptarët e arrestuar sot kanë lidhje me dy bashkëkombësit e kapur dje me 60 kg heroinë.

LIBRAZHËD. Një 18-vjeçar nga Librazhdi i ka dhënë fund jetës në mënyrë tragjike duke u vetëdhur nga ura e Bushtricës. Ngjarja ka ndodhur dje rreth orës 12:00, pasi i riu kishte mbaruar mësimin. Fatjon Feçi ishte nxënës në vitin e tretë në gjimnazin e fshatit Qukës. Mësohet se mëngjesin e djeshëm nëna e adoleshentit i kishte rrefyer mësueses se i biri ditë e fundit kishte qenë i mbyllur, ndaj të kujdesej pak për të. Nga ana e saj mësuesja ka pohuar se nuk ka vënë re ndonjë shqetësim tek 18-vjeçari. Lajmi për vetëvrasjen e gjimnazistit i ka tronditur të gjithë. "Fatjoni ishte

Drejtoresha e gjimnazit: Lajmi na ra si bombë

Hidhet nga ura 50 m e lartë pas mësimit, humb jetën tragjikisht nxënësi 18-vjeçar



fëmijë i mrekullueshëm. Lajmi na ra si bombë, nuk na besohet ende". Kështu tha mes lotësh Mira Golikja, drejtoresha e gjimnazit "Dilaver Nezha" që frekuentonte Feçi. Në një prononcim për "News 24" dhe "GSH", Golikja u shpreh me fjalët më të mira për Fatjoni dhe familjen e tij. Ashtu si të gjithë ata që e njihnin edhe ajo nuk gjen arsye për këtë vdekje, ende

të paqartë dhe të pabesueshme. "Fatjoni kishte një familje të mirë, vetë ishte më i rregullti, fëmijë i urtë. Nuk di çfarë të them", tha drejtoresha e shkollës. Ndërkaq, drejtoresha mohon çdo përfshirje të Fatjonit në ndonjë konflikt apo sherr në shkollë. "Nuk largohet kurrë nga orët e mësimi. Ishte i qetë. S'ka pasur konflikte dhe ne nuk kishim



18-vjeçari Fatjon Feçi

vënë re asgjë të dyshimtë apo të ndryshme në sjelljen e tij", shtoi Mira Golikja. Gjithashtu, kjo e fundit tha se mësuesi kujdestar dhe mësues të tjerë kanë dhënë dëshminë e tyre për policinë për të qartësuar rrethanat e ngjarjes dhe motivin që çoi në vdekjen e të riut. 18-vjeçari

Fatjon Feçi në vitin e tretë në gjimnazin e Qukësit dyshohet se u hodh dje nga ura 50 metër e lartë e Bushtricës duke gjetur vdekjen. Policia ende nuk e ka referuar ngjarjen në prokurori. Mësohet se hetuesit nuk kanë gjetur shenja dhune në trupin e të riut.

BUXHETI 2018 DISKUTIMET

Në vitin 2018 është parashikuar fondi për dëmshpërblimin e 5400 ish-të përndjekurve

Ahmetaj: Kemi 4 mld lekë për fondin e kompensimit të pronarëve

Ahmetaj kundër FMN-së për PPP-të

Ornela Manjani

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka njohur dje deputetët e Komisionit të Ekonomisë me shpenzimet që janë parashikuar të kryhen vitin e ardhshëm. "Investimet publike do të arrijnë 86 mld lekë këtë vit, nga ku 22.4 do të jenë për investimet në rrugë. Kemi 4 mld lekë për fondin e kompensimit të pronarëve. Fondi për pronarët kulmon në 2020 me 5.5 mld lekë. Fondet për ish-të përndjekurit, 2 mld lekë ose 0.1 të PBB-së, për dëmshpërblimin e 5400 ish-të përndjekurve. Do të rimbursohen 180 barna plus në listën e rimbursimit, me një fond 4.8 milionë lekë. Investimet publike, 86 mld lekë", tha ministri në seancën djeshme, ku është bërë analiza e të gjitha shpenzimeve të parashikuara në projekt-buxhetin e vitit të ardhshëm.

PPP-të

Ish-ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti i kërkoi shpjegime ministrit në lidhje me deklaratën e kreu të FMN-së për trajtimin e PPP si borxh. Në këtë kontekst, ministri Ahmetaj tha se për çështje teknike, PPP nuk njihen si borxh për shkak të EPSA95. Sipas tij, vlera e koncesioneve në 2018 parashikohet 78 milionë dollarë. FMN ka paralajmëruar disa herë së fundmi qeverinë shqiptare që të ketë një transparencë më të lartë për projektet e partneritetit publik-privat dhe që ato të llogariten si borxh, në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. "Detyrimet që i takojnë shtetit nga PPP-të duhet të regjistrohen sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, çka do të thotë që PPP-të kontribuojnë në borxhin publik. Praktikata aktuale në planifikimin dhe ekzekutimin e investimeve nuk i plotësojnë këto standarde, duke rritur rrezikun që të përzgjidhen projekte të varfra dhe që rreziqet fiskale të nënvlerësohen", ka po-



Komisioni i Ekonomisë

AHMETAJ

"Detyrimet që i takojnë shtetit nga PPP-të duhet të regjistrohen sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, çka do të thotë që PPP-të kontribuojnë në borxhin publik. Praktikata aktuale në planifikimin dhe ekzekutimin e investimeve nuk i plotësojnë këto standarde, duke rritur rrezikun që të përzgjidhen projekte të varfra dhe që rreziqet fiskale të nënvlerësohen"

"Qeveria, paketë fiskale për rritjen e taksave"

Bode: Qytetarët, 'thesi' nga do dalin të ardhurat

Ish-ministri i Financave më kohën kur qeveriste PD-ja, Ritvan Bode, tekta komenti buxhetin 2018, theksoi se ky nuk është një program që parashikon rritje ekonomike. I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24", Bode pohoi se me këtë buxhet, sektori i bujqësisë është lënë jashtë vëmendjes. Mes të tjerash, Bode u ndal edhe tek vendimi i qeverisë për paketën fiskale, ndërsa shtoi se kjo do të shoqërohet me rritje taksash, që do të rëndojnë për qytetarët e thjeshtë. Bode tha se "thesi" nga i cili qeveria do të nxjerrë të ardhurat shtesë është buxheti familjar. "Qeveria vjen me një paketë fiskale, që në thelbën e saj rrit taksat. 48 milionë dollarë taksat shtesë neto.



Në total po t'i marrim këto 5 vite, janë 5 mln dollarë taksat shtesë për qytetarët, pasi janë taksat konsumi, që janë shtuar gjatë kësaj periudhe. Qeveria e sheh se nuk ka si të rrisë konsumin. Kjo taksë e re që vendoset godet konsumin, pasi rëndojnë qytetarët e thjeshtë. Kemi rritje po ashtu të disa taksave, që cilësohen si taksat mbi konsum-

in. Qeveria ka deklaruar se do shkojë deri në tavanin poshtë 20 mijë lekë të reja në vit. Qeveria i kontribuon në mënyrë negative konsumin dhe rritja e pensioneve nuk deklarohet qartë. Shuma e vendosur në buxhet do jetë e pamjaftueshme për shtesat e reja. Nuk mendoj se për 2018-ën do të bëhet rritje pensionesh apo pagash. Mendoj se është vënë në qendër të goditjes nga pikëpamja e taksave. "Thesi" nga i cili qeveria do të nxjerrë të ardhura shtesë është buxheti i konsumit familjar", tha Bode. Demokriti tha se është kundër faktit që qeveria të marrë borxh, që sipas tij është i padeklaruar dhe se nuk do t'i shërbejë vendit dhe as zhvillimit ekonomik.

huar përfaqësuesi i përhershëm i FMN-së, Jens Reinke, në një intervistë të fundit për FMN. Dhënia e shumë objekteve apo shërbimeve publike me koncesion, apo siç ka nisur të quhet vitet e fundit, Partneritet Publik Privat është objekt debati gjithnjë tashmë. Gjatë seancës së prezantimit të zërit të shpenzimeve të buxhetit të vitit të ardhshëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, u shpreh se fatura

e planifikuar për vitin e ardhshëm kap vlerën e 78 milionë dollarëve. Sipas tij, këto janë pagesa për koncesionet e dhëna vite më parë, por edhe për PPP. "Vlera e koncesioneve brenda llogarisë kapitale për vitin 2018 është rreth 78 milionë dollarë, pra nuk ka shkuar akoma as 3% e të ardhurave totale tatimore përtej nivelit 5%. Programi "1 miliard dollarë" i PPP-ve është një program, i cili fokusohet tek in-

vestimet në infrastrukturë, kryesisht në segmentet kryesore të vendit dhe do të financohet në të dyja mënyrat: qoftë në kombinim PPP 'project financing', qoftë me toll, pra 'traffic volume guarantee', pra garanci të risikut të trafikut", tha Ahmetaj. Gjithashtu, sipas ministrit të Financave, tashmë me aktin normativ janë shlyer 3.6 miliardë lekë detyrime të prapambetura të krijuara në muajt e parë të këtij viti.



Tabaku: Qeveria, 18.4 mln dollarë për shpenzime luksi

Gjatë diskutimit për shpenzimet dhe investimet, nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku, theksoi se koncesionet po gërryejnë ekonominë. Ajo tha se qeveria ka dëshmuar se është e paafte të realizojë investime publike. "U rritën me 30% nga viti kaluar shpenzimet për koncesionet, duke kapur vlerën e 9.4 MLD lekë dhe këtu nuk është llogaritur projekti 1 miliard euro për infrastrukturën. Qeveria ka dëshmuar se është e paafte të realizojë investime publike dhe e orientuar nga praktikata korruptive, prandaj po i jep me koncesion", - tha Tabaku. Ajo theksoi se qeveria në këtë projektbuxhet vazhdon të mos parashikojë rritje pagash, ndërkohe që rrit me 48 mld dollarë taksat. Një pjesë e mirë e të ardhurave që do të sigurohen nga rritja e taksave do të shkojnë për shpenzime. "Rriten me 15 mln USD shpenzimet e qeverisë operative dhe mirëmbajtje, 3.7% më shumë sesa viti 2017. Ulen me 19 mln USD fondet për infrastrukturën vendore dhe rajonale, një vlerë që është 21% më e ulët se sa vlera e alokuar për vitin zgjedhor 2017. Të njëjtin fat kanë edhe shpenzimet sa u takon investimeve për kanalet ujtëse dhe kullimit, të cilët janë ulur me 13% në raport me një vit më parë, pra 2.1 mln USD më pak", - tha Tabaku. Sipas Tabakut, qeveria ka parashikuar 18.4 mln dollarë rritjen e shpenzimeve për rikonstrukcione zyrrash, pajisje zyrrash dhe makinash.

"Akti normativ i dy ditëve më parë pastroi të gjitha detyrimet e prapambetura, të krijuara pesë muaj e fundit, sidomos në sektorin e infrastrukturës, pra praktikisht që nga dje nuk ka më detyrime të prapambetura të trashëguara, sidomos në sektorin e infrastrukturës, ku prapambetja ishte 3.6 miliardë lekë", u shpreh Ahmetaj. Ndërsa, nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku, e ka cilësuar këtë si një paafte të qeverisë për të bërë investime publike dhe për të menaxhuar buxhetin. "Qeveria është e paafte për të bërë investimet publike dhe të gjitha investimet publike është duke i transferuar nëpër koncesione, ose partneritetet publik-privat,

siç keni dëshirë t'i qani, ose siç preferoni ta qani. Koncesionet janë duke e gërryer buxhetin e shtetit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë dhe koncesionet janë duke u bërë diskutimi parësor edhe i partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe këtu i referohem FMN-së. Keni sjellë një ligj me koncesione, i cili e rrit me 30% koston e tyre nga viti i kaluar. Është 9.4 miliardë lekë në mos gaboj", tha Tabaku. Referuar zërit të shpenzimeve në buxhetin e shtetit për vitin e ardhshëm, investimet publike kapin vlerën e 86.1 miliardë lekë ose 5.2% e PBB. Ndërsa, të gjitha shpenzimet buxhetore janë parashikuar në vlerën e 496.6 miliardë lekëve.



Ministri i Financave Arben Ahmetaj

ZRPP nuk shërbejnë prej disa javësh

Konfindustria: Hipotekat nuk punojnë, bllokojnë bizneset

Konfindustria ka shprehur shqetësimin lidhur me mungesën e plotë të aktivitetit prej një kohe të gjatë të Zyrate të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Sipas informacionit të ardhur pranë Konfindustrisë nga bizneset, thuhet në njoftim, rezultojnë se në shumë rrethe, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk shërbejnë prej disa javësh. "Kulmin e paraqet Zyra e Regjistrimit të Rrethit të Përmetit, ku ka afërsisht 3 muaj, që praktikisht është e mbyllur dhe nuk shërbehet për bizneset dhe qytetarët. Të prekur janë edhe investitorët të huaj të pranishëm në vend." deklarohet nga Konfindustria. Konfindustria vlerëson, se procesi i rifreskimit të stafëve drejtues të zyrate të regjistrimit në asnjë mënyrë nuk



Administratori i përgjithshëm Gjergj Buxhuku

mund të justifikojë mbylljen e shërbesës së tyre për bizneset dhe qytetarët. Pasoja janë të rënda të përlogaritura në kosto të humbjes së

kohës dhe drejtpërdrejt në shpenzime financiare shtesë. Proceseve burokratike të garave përzgjedhëse të personelit duhet t'i ishte paraprirë,

qoftë edhe me komandime të përkohshme me qëllim që puna të vazhdonte pa u ndërprerë, qoftë edhe një orë të vetme. "Konfindustria do të kërkojë zyrarisht nga kryeministri, z. Rama, por edhe vendimmarrja politike në përgjithësi, të ndërhyjnë në një kohë sa më të shpejtë pranë Ministrisë së Drejtësisë për t'i dhënë fund një fenomeni të tillë krejtësisht të paarsyeshëm dhe të papranueshëm, që prodhon pasojat të rënda për bizneset dhe qytetarët, por njëkohësisht edhe ul seriozitetin e institucioneve të shtetit shqiptar para investitorëve të huaj." thotë administratori i përgjithshëm Gjergj Buxhuku.

ISSH-ja, fshati braktis skemën numri i kontribuuesve u tkurr 40%

Ornela Manjani

Pensionet, Ahmetaj: Do të ndryshojmë skemën

Fermerët nuk sigurohen, ministri premtion lehtësira

Qeveria do të ndryshojë skemën e pensioneve. Shkak është bërë ulja e numrit të kontribuuesve për shkak të rritjes së detyrimeve. Skema ka rezultuar problematike në fshat, pasi për shkak të rritjes së kontributeve fermerët nuk po sigurohen. Ndryshimet në skemë janë paralajmëruar nga Ministri i Financave Arben Ahmetaj, i cili bërë të ditur se do të kryhen ndërhyrje rregulluese. "Pjesa e reformës së pensioneve që i adresohet fshatit nuk po funksionon", tha Erjon Braçe, deputet i PS-së. Kontributi për të përfutur pension në fshat është 62 mijë lekë në vit. Por vetë fermerët paguajnë nga 29 deri në 38 mijë lekë në vit, ndërsa gjysmën tjetër e subvencionon qeveria. Por edhe me këtë subvencion një pjesë e madhe e fermerëve nuk po sigurohen. "Për të qënë shumë transparent me komisionin unë kam nevojë për dy muaj kohë për të avancuar ndryshimet ligjore", tha Ahmetaj. Ministri i Financave tha se qeveria po diskuton dy variante. "Një nga mënyrat është që, pagën minimale e cila është baza e kontributit, përdërisa në fshat nuk ka atë dëshirë për të paguar ta ulim, ta bëjmë pak më shumë se gjysma e pagës minimale në mënyrë që baza në fshat të jetë më e ulët që përdoret si referencë për kalkulimin e kontributeve", vijon ministri. Ky variant përbën një ndryshim madhor të skemës. Ulja e pagës minimale përgjysmon kontribu-



Foto ilustruese

tin për fermerët dhe lehtëson buxhetin nga subvencioni. Por në të njëjtën kohë ajo ul ndjeshëm përfitimin kur fermeri del në pension. Por qeveria do bëjë dhe një përpjekje të fundit ndërgjegjësimi. "Unë besoj që lajmërimi i cdo pensionisti në fshat ku ti thuhet që po nuk pagove pensionin ynë kur të dalësh në pension do jetë jetë kaq", thotë Ahmetaj.

RAPORTI I KLSH

Në vitin 2016 ecuria në skemën e pensioneve u karakterizua nga një seri zhvillimesh të rëndësishme ku

mes të tjerave një tkurrje me 40% e kontribuuesve të fshatit. Referuar raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e buxhetit faktik rezultojnë se kontribuues nga fshati vitin e kaluar ishin 53,168 duke shënuar rënie në raport me 2015. "Rezultati financiar i degës së pensionit të fshatit, vazhdon të mbetet problematik për shkak të numrit të vogël të siguruarve në bujqësi dhe nivelit të ulët të pagës minimale. Kështu, deficit i financiar i degës së pensioneve të fshatit ka rezultuar 11,593.2 milion lekë, nga 10,716.3 mil-

ion lekë që ishte një vit më parë, ose 8.2% më shumë se një vit të parë" thuhet në raportin e KLSH. Kjo situatë ka përkeqësuar edhe raportin e mbulimit ku të ardhurat nga dega e pensionit të fshatit mbulojnë vetëm 22% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 28% një vit më parë. Situata paraqitet më mirë në qytet ku kemi një rritje të mbulimit. Në fund të vitit 2016 të ardhurat nga dega e pensionit të qytetit mbulojnë 80.7% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 77.7% një vit më parë. Në total e gjithë

skema duket se ka një ulje të deficitit i cili ka ardhur si efekt i rritjes së të ardhurave me 10.4 për qind dhe uljes së shpenzimeve me 6.3 për qind në raport me një vit më parë. Efekt pozitiv duket se ka dhënë rritja graduale e moshës së daljes në pension për gratë me dy muaj çdo vit. Në vitin 2016 efekti i kësaj mase llogaritet në 400 milion lekë.

STOKU I BORXHIT NË SKEMË

Bizneset private por edhe entet shtetërore duket se vijnë në akumulimin e borxheve në skemën e pensioneve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit nënvizon se numri i bizneseve të mëdha debitorë u rrit me 11,634 subjekte në shumën 3.1 miliardë lekë kurse vlera totale e borxhit të këtyre subjekteve në fund të vitit 2016 është 9.4 miliardë lekë. "Me rritje dhe në mënyrë shqetësuese mbetet trendi i subjekteve me borxh dhe në sektorin publik ku rritjen më të madhe e ka sektori buxhetor me 608 subjekte në shumën 406,522 mijë lekë. Vlera totale e borxhit të subjekteve publike në fund të vitit 2016 është 2.1 miliardë lekë" nënvizon KLSH.

DEFICITI

Deficiti i financiar i degës së pensioneve të fshatit ka rezultuar 11,593.2 milion lekë, nga 10,716.3 milion lekë që ishte një vit më parë, ose 8.2% më shumë se një vit të parë" thuhet në raportin e KLSH. Kjo situatë ka përkeqësuar edhe raportin e mbulimit ku të ardhurat nga dega e pensionit të fshatit mbulojnë vetëm 22% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 28% një vit më parë.

PENSIONET

ERJON BRAÇE: Në fshat ka një rënie dhe një deficit dramatik që do të thotë se pjesa e reformës së pensioneve që i adresohet fshatit nuk po funksionon. Nuk binden bujqit që të paguajnë atë normë sigurimesh që është vendosur me reformën e re të pensioneve dhe natyrisht kjo akumulon deficitin nga njëri vit në vitin tjetër. Keni ndërmend ta rishikoni këtë pjesë apo jo?

ARBEN AHMETAJ: Brenda dy muajsh do të rishikohet e gjithë formula.

KURBIN - Një shpërthim me eksploziv i ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm ka tronditur banorët e fshatit Gurëz të Kurbin. Burime nga policia lokale bënë me dije se persona ende të paidentifikuar kanë vendosur lëndë plasëse në një banesë, në pronësi të Frederik Kastriotit, i cili është emigrant në Itali. Mësohet se si pasojë shpër-



Banesa e dëmtuar nga tritolli

Shpërthim me eksploziv, shkatërrohet shtëpia në ndërtim e emigrantit Kastrioti

thimit janë shkatëruar vetëm dëme materiale dhe nuk ka pasur persona të lënduar. Kjo për faktin se banesa ishte në ndërtim dhe larg banesa të tjera. Pas sinjalizimit për ngjarjen, policia ka shkuar menjëherë në f-

shat Gurëz dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimt. "Rreth orës 07:00, në sallën operative të komisarariatit të policisë Kurbin, ka ardhur një telefonatë se në banesën e sh-

tetasit F.K., e cila është në ndërtim, gjatë natës ka shpërthyer një sasi lëndë plasëse. Në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e policisë dhe grupi hetimor, ku nga verifikimet paraprake rezultoi se: Në banesën në ndërtim

e sipër të shtetasit F.K., emigrant në Itali është vendosur dhe ka shpërthyer një sasi lëndë plasëse. Si pasojë e shpërthimit janë dëmtuar pjesërisht muret dhe një pjesë e soletës. Grupi hetimor vijon hetimet në vendin e ngjarjes, si dhe po punohet në mënyrë intensive për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Banorët: Grabitësit përfituan nga mungesa e dritave, jemi të frikësuar



BERAT

Persona të maskuar dhe të armatosur kanë dhunuar e grabitur një çift në fshatin Donofrosë të Bashkisë Ura Vajgurore. Bashkëshortët Osmën dhe Drita Baxhia, përkatësisht 57 dhe 55 vjeç janë terrorizuar kur janë përballur me maskat në shtëpinë e tyre. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Beratit dje bënë me dije se ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e së martës, rreth orës 21:15. Mësohet se agresorët kanë shfrytëzuar mungesën e dritave në fshat për të hyrë në banesën e Baxhijave, ku ndodheshin vetëm bashkëshortët. Pasi kanë kthyer shtëpinë përmby, personat e maskuar kanë marrë nën kërcënimin e armëve vetëm dy celularë dhe më pas janë larguar me shpejtësi. Ndërkaq, blutë të njoftuar për grabitjen kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimin për identifikimin dhe arrestimin e autorëve.

NGJARJA

Mbrëmjen e së martës, disa persona të maskuar kanë hyrë në banesën e familjes Baxhia, por janë pikasur nga të zotët e shtëpisë. Kryefamiljari Osmën Baxhia dhe bashkëshortja e tij kanë rezistuar dhe janë përleshur me agresorët, të cilët u kanë kërkuar t'u dorëzonin paratë. Grabitësit kanë godi-

Berat, bashkëshortët dhunohen në banesë nga maskat për dy celularë

Agresorët goditën burrë e grua me qytën e armës



Banesa e familjes Baxhia

tur me qytën e armës 57-vjeçar. Ndërkohë që gjatë përleshjes ka ndërhyrë edhe bashkëshortja e tij, Drita për të mbrojtur të shoqin, por edhe ajo është dhunuar. Autorët kanë kontrolluar dhomë më dhomë, por kanë mundur të marrin me vete vetëm dy telefona celularë dhe më pas janë larguar. Të tronditur, burrë e grua kanë

njoftuar policinë, e cila ka shkuar në vendngjarje dhe kanë bërë krehjen e zonës. Me gjithë kërkimet e bëra, ende nuk është bërë e mundur identifikimi dhe kapja e autorëve të krimt.

POLICIA

"Rreth orës 21:15, në sallën operative ka mbërritur një telefonatë se në fshatin Donofrosë, Ura Vajgurore, disa

BANORËT

Ngjarja ka tronditur jo vetëm familjen Baxhia, por edhe banorët e fshatit Donofrosë, të cilët thanë se ndihen të frikësuar. "Autorët kanë përfituar nga mungesa e dritave. Në fshat nuk ka pasur drita gjatë të gjithë deri në mbrëmje. Ne kemi shumë frikë pas asaj që ndodhi, ndaj policia duhet të marrë masa", pohuan banorët.

zulton se disa persona të maskuar dyshohet të armatosur kanë hyrë në banesën e tyre. Pasi kanë hyrë në banesë, ata janë konfliktuar me çiftin, duke e goditur shtetasin O.B., në kokë me qytë të armës. Bashkëshortja e tij ka ndërhyrë ku dhe kjo ka pësuar dëmtime të lehta", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ngjarja ka tronditur jo vetëm familjen Baxhia, por edhe banorët e fshatit, të cilët thanë se ndihen të frikësuar. "Sot (dje) në mëngjes e morëm vesh se persona të armatosur kishin grabitur bashkëshortët Baxhia. Autorët kanë përfituar nga mungesa e dritave. Në fshat nuk ka pasur drita gjatë të gjithë deri në mbrëmje. Ne kemi shumë frikë pas asaj që ndodhi, ndaj policia duhet të marrë masa të menjëhershme", pohuan banorët. Ndërkaq, ata thanë se bashkëshortët Baxhia jetojnë vetëm, pasi e kanë djalin në Angli.



Caritas Shqiptar
Albania

LAJMËRIM PËR KONTRAKTIM KOMPANIE NDËRTIMI

Caritas Shqiptar kërkon të kontrakttojë një kompani ndërtimi për të kryer punime si:

- Rinovimin dhe mobilimin e një ambjenti të përcaktuar si dhomë intervistimi në Drejtorinë Rajonale të kufirit dhe Migracionit në Shkodër.
- Rinovimin dhe mobilimin e një ambjenti të përcaktuar si dhomë intervistimi në Drejtorinë Rajonale të kufirit dhe Migracionit në Kukës.


Informacionin për zhvillimin e këtij tenderi mund ta gjeni duke u interesuar në adresën e facebook-ut: "Caritas Albania-Shqiptar".

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: **10.11.2017, ora 14:00.**

Adresa për dorëzimin e dokumentacionit:

Rruga "Don Bosko", Nr. 4 Tiranë;
Tel: + 355 4 22 30088; Fax: + 355 4 22 34327

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP for Publication of Municipal Council Decisions at Albanian LGUs STAR 2

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 42326**
RFP for Publication of Municipal Council Decisions at Albanian LGUs STAR 2

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 17th of November 2017

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor

Presidenti i SPASH: Ministria e Arsimit po shkel ligjin, do protestojmë

Voltiza Duro

Që prej 31 majit të 2017, afati i kontratës kolektive mes sindikatave të arsimit dhe MASR ka përfunduar, duke lënë në pritje plot 36 mijë mësues në mbarë vendin. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", presidenti i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, Nevrus Kaptelli tregon se pavarësisht kërkesave zyrtare të vazhdueshme, ende nuk kanë marrë një përgjigje për fatin e rinovimit të kontratës. Gjithashtu, presidenti nxjerr në pah edhe probleme të tjera si shpërblimet e mësuesve, të cilat prej 4 vitesh nuk bëhen reale. Sipas tij, edhe shumë punësime të mësuesve nëpërmjet portalit, nuk janë bërë mbi meritokracinë, e madje ka pasur raste punësimesh edhe pa aplikime në portal. Kaptelli thotë se nëse Ministria e Arsimit, nuk i jep një zgjidhje problemeve të tyre, veçanërisht rinovimit të kontratës, SPASH do të përdorë çdo rrugë të mundshme ligjore, madje edhe protestat për të vënë në vend dinjitetin e mësuesve.

Kur i ka fillesat Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë?

Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë është krijuar në vitin 1991, me fillimin e proceseve demokratike në vend. Fillimisht, ajo ishte pjesë e bashkimit të sindikatave të pavarura të Shqipërisë. Që nga ajo kohë në Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë u regjistruan pjesa më e madhe e mësuesve në mbarë vendin dhe sot SPASH është një nga sindikatat më të mëdha për arsimin në Shqipëri.

Cili është misioni i saj?

Misioni jonë është që të mbrojmë të drejtat e mësuesve në Shqipëri e kjo realizohet edhe nëpërmjet kontratës kolektive. Në SPASH kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë mësuesit që janë të punësuar në arsimin parauniversitar, gjithashtu, edhe punonjësit ndihmës. Në Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë dhe në Federatën Sindikale të Arsimit dhe Shkencës, FSASH, e cila është aleatja jonë, janë të regjistruar mbi 70% e mësuesve të Shqipërisë dhe kjo na dha të drejtën e nënshkrimit të kontratës kolektive me MASR. Kjo kontratë rregullon të gjitha marrëdhëniet e punës mes mësuesve dhe Ministrisë së Arsimit dhe me DAR-et e rretheve.

A është rinovuar kontrata kolektive nga Ministria e Arsimit?

Në 16 dhjetor 2015 u nënshkrua kontrata kolektive, e cila përfundoi në 31 maj të 2017-ës. Ne iu drejtua Ministrisë së Arsimit që në 16 mars të këtij viti në mënyrë që të fillonin procedurat për nënshkrimin e kontratës së

Kaptelli: Mësuesit pa kontratë kolektive pune prej 5 muajsh

"Drejtuesit e DAR-it, punësime edhe pa portal"

KONTRATA

Afati i kontratës kolektive mes sindikatave të arsimit dhe MASR ka përfunduar, duke lënë në pritje plot 36 mijë mësues në mbarë vendin. Pavarësisht kërkesave zyrtare të vazhdueshme nga ana e SPASH, ende nuk kanë marrë një përgjigje për fatin e rinovimit të kontratës.

PUNËSIMET PA PORTAL

"Nga të dhënat, që na vijnë nga rrethet, ndodh që pjesa më e madhe e drejtuesve të DAR-it në rrethe nuk i punësojnë mësuesit nëpërmjet portalit. Thëksoj këtu që mësuesi Neki Hysa në Dibër edhe pse ka dalë i pari në portal, para tij janë punësuar të tjerë që renditeshin më poshtë se ai. Zyra Arsimore e Kamzës madje ka arritur të punësojë mësues edhe pa portal", - thotë Kaptelli.

por. Për marrëveshja kolektive ngeli e panëshkruar edhe pse ne i paraqitëm provat e përfaqësueshmërisë e ishimit në përputhje me ligjet e përcaktuara në Kodin e Punës. Pra, rreth 36 mijë mësues të arsimit parauniversitar kanë ngelur pa kontratë prej shumë muajsh.

A e keni kërkuar një zgjidhje nga instancat përkatëse?

Gjatë gjithë kësaj kohe ne jemi përballur me MASR dhe me Drejtoritë Arsimore Rajonale në rrethe me probleme të pazbatueshmërisë së ligjit të arsimit parauniversitar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky problem na ka shoqëruar gjatë gjithë kohës e madje kemi bërë edhe protesta para godinës së MAS. Ajo çka na shqetëson më shumë ne si sindikatë është fakti që Ministria e Arsimit nuk e zbaton ligjin e arsimit parauniversitar ku në nenin 2 pika 18 thuhet se partnerët socialë janë sindikatat e arsimit me të

cilat MASR nënshkruan kontratat kolektive të punës.



Presidenti i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, Nevrus Kaptelli



Cila ishte përgjigja që morët nga Ministria e Arsimit mbi rinovimin e kontratës?

Ministria e Arsimit nuk e ka marrë mundimin të rinovojë kontratën, pavarësisht kërkesave tona zyrtare që kanë ngelur pa përgjigje. Drejtori juridik i këtij institucioni është bërë pengesë pasi nuk është dashmires ndaj sindikatave të arsimit dhe nuk respekton partneritetin me ne.

Sa ka bashkëpunuar Këshilli Kombëtar i Arsimit me MASR?

Për më shumë se 4 vite, Ministria e Arsimit në vendin tonë nuk ka marrë asnjë hap për të vënë në funksion Këshillin Kombëtar të arsimit parauniversitar. Kjo është dicka e paparueshme, sepse ata pretendojnë se bëjnë reforma dhe këto reforma nuk kanë kaluar nga ky Këshill. Kështu që nuk pretendoj që të ketë reforma të suksesshme kur nuk përfshihen të gjithë aktorët e arsimit. Gjatë gjithë këtyre viteve ne asnjëherë nuk jemi thirrur për diskutimet mbi projektbuxhetin e arsimit nga kjo ministri, ndërkohë që kemi të drejtë me ligj.

"MËSUESI AGRONOMI"

"Nuk larguan nga puna ata që ishin jashtë profilit, por hoqën nga puna mësues me 30 vite punë e të kualifikuar që dolën të parët në portal dhe guxuan të punësonin jashtë sistemit edhe agronomë, madje edhe mësues që ishte dënuar më parë me burg. Por drejtoresha e vendosur në krye të DAR-it në Dibër ende po vazhdon këtë rrugë, kjo për faktin edhe se janë të përfshirë në politikë", - shprehet presidenti i SPASH.

Sa të kënaqur janë mësuesit e arsimit parauniversitar me pagat aktuale?

Në 4 vitet e shkuara, mësuesit e sistemit parauniversitar kanë qenë më të diskriminuarit në paga. Pas kërkesës sonë u ndryshua VKM, dhe mësuesit patën një rritje page të papërfillshme, e cila nuk mbulonte as inflacionin. Një pjesë e mësuesve marrin edhe më pak sesa merrnin para rritjes së pagës në bazë të VKM. Dega Ekonomike e MASR ka premtuar që do e zgjidhi pas denoncimit tonë, por nuk morëm asnjë zgjidhje.

A kanë marrë shpër-

blime mësuesit në fund të vitit?

Pas ardhjes së Nikollës në krye të Ministrisë së Arsimit, mësuesit kurrë nuk e morën shpërblimin, pavarësisht protestave e kërkesave tona. Vitin e kaluar është përdorur një mënyrë shumë e turpshme, ku ministria Nikolla ka shtruar darka për mësuesit për të ulur tensionin e për t'i mbyllur gojën mësuesve, duke luajtur shumë keq me dinjitetin e tyre.

Sa i besueshmë është aplikimi përmes portalit nga ana e mësuesve?

Nga të dhënat që na vijnë nga rrethet ndodh që pjesa më e madhe e drejtuesve të DAR-it në rrethe nuk i punësojnë mësuesit nëpërmjet portalit. Thëksoj këtu që mësuesi Neki Hysa në Dibër edhe pse ka dalë i pari në portal, para tij janë punësuar të tjerë që renditeshin më poshtë se ai. Zyra Arsimore e Kamzës madje ka arritur të punësojë mësues edhe pa portal.

Si e vlerësoni ju procesin e anketimit?

Ky proces për ne është një tallje që bëhet me mësuesit, krejt i panevojshëm, i cili nuk do të sjellë asgjë të dobishme.

Si paraqiten marrëdhëniet e SPASH me Drejtoritë Arsimore Rajonale?

Ne kemi denoncuar veprimtarinë e jashtëligjshme të disa DAR-eve në vend. Vlen të përmend këtu rastin e Drejtorisë Arsimore të Dibërit, e cila në kundërshtim me arsimin parauniversitar dhe aktet nënligjore për punësimet, lëvizjet paralele e largimet nga puna nuk larguan nga puna ata që ishin jashtë profilit, por hoqën nga puna mësues me 30 vite punë e të kualifikuar që dolën të parët në portal dhe guxuan të punësonin jashtë sistemit edhe agronomë, madje edhe mësues që ishte dënuar më parë me burg. Por drejtoresha e vendosur në krye të DAR-it në Dibër ende po vazhdon këtë rrugë, kjo për faktin edhe se janë të përfshirë në politikë.

A janë denoncuar këto raste shkeljeje nga ana juaj si sindikatë?

Të gjitha këto ne i kemi denoncuar, por një pjesë e tyre jo vetëm nuk kanë gjetur zgjidhje, por kanë cenuar rëndë figurën e disa mësuesve. Kështu që mësuesit me mbështetjen tonë kanë nisur proceset gjyqësore ku dhe kanë fituar.

Cila është thirrja juaj ndaj Ministrisë së Arsimit?

I bëjmë thirrje Ministrisë së Arsimit që të respektojë ligjin e arsimit parauniversitar dhe të nisë sa më shpejt procedurat për rinovimin e kontratës kolektive, në të kundërt neve nuk na pengon asgjë për të përdorur të gjitha mjetet që na lejon ligji, deri në protestë për të mbrojtur të drejtat e mësuesve.

SHKRIMTARET NE DIKTATURE DOKUMENTET

EKSKLUZIVE / Zbulohet korrespondenca "Tepër sekret" në vitin 1989 ku këngëtarjaurvejohej nga Sigurimi i Shtetit

Telefonata nga SHBA: "Do martohem me Eli Farën" që alarmoi Byronë Politike në '89-ën?!

Raporti i Jorgo Melicës: Vera Grabocka i ka thënë se problemin e martesës t'ia ngrejë shokut Spiro Dede, i cili mund ta ndihmojë që të bëhet kjo lidhje me Agimin

Dashnor Kaloçi

Edhe pse kishte kaluar gjysma e dytë e vitit 1989 dhe në mjaft prej shteteve të Europës Lindore kishin filluar të ndiheshin "erërat" që vinin nga përtej Atlantikut, në Shqipërinë komuniste dukej se nuk po frynte e nuk po lëvizte asgjë dhe "ujerat" rrinin po në vend?! Madje dukej sikur gjërat po shkonin mbrapsht dhe situata po përkeqësohej gjithnjë e më shumë për shkak të gjendjes ekonomike tejet të vështirë që po kalonte vendi, gjë e cila lidhej direkt me politikën e izolimit që vazhdonte të aplikonte Tirana zyrtare me udhëheqjen e saj. Si rezultat i kësaj, edhe në art e kulturë vazhdonte e njëjta gjë dhe diktati i regjimit komunist vazhdonte të ndihej po njëllot të shkrimtarët e artistët, madje për vetë famën, emrin, autoritetin apo dhe disa privilegje që kishin e gëzonin ata te dhe ndaj shtresës tjetër të shoqërisë shqiptare, diktati dhe kontrolli partiak e shtetëror ndaj tyre ishte edhe më i fortë e më i rreptë. Jo vetëm kaq, por partia dhe shteti nëpërmjet "organeve kompetente" (Sigurimi i Shtetit), vazhdonte të futej dhe ndërhynte thellë



Regjisoria Vera Grabocka

deri në jetën private të njerëzve të artit e kulturës, njëllot si në periudhën më të vështirë që kishin kaluara ata, atë të pas Festivalit të 11 të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar, e Plenumin e V-të të Komitetit Qendror të PPSH-së. Kjo gjë, veç të tjerash, si dhe në dokumentet e ndryshme arkivore të publikuara në faqe të ndryshme të këtij libri, bëhet e ditur edhe nga këto që po publikojmë në këtë ka-



Këngëtarja Eli Fara

pitull, ku udhëheqja më e lartë partiake e shtetërore e regjimit komunist të Tiranës, është alarmuar pas një telefonate që është bërë nga SHBA, lidhur me këngëtarën e njohur Eli Fara. Siç do të shohim edhe në dokumentet në fjalë, ajo që vihet re nga përmbajtja e tyre, nuk është vetëm fakti që ka të bëjë me ndërhyrjen në jetën private të këngëtares së famshme, për të cilën janë vënë në alarm dhe

lëvizje krerët më të lartë të udhëheqjes shqiptare të asaj kohe, (Lenka Çuko, anëtare e Byrosë Politike dhe sekretare e Komitetit Qendror, Simon Stefani, anëtar i Byrosë Politike, sekretar i Komitetit Qendror dhe ministër i Punëve të Brendshme, Reiz Malile, anëtar i Komitetit Qendror dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Anastas Kondo, funksionar i lartë për Artin e Kulturën në Komite-



tin Qendror, Jorgo Melica, Kryetar i Komitetit për Marrëdhënie Miqësore dhe Kulturore me jashtë, etj. etj.), as "statusi" i fortë i personit që interesohej të lidhte jetën me këngëtarën në fjalë, gjë e cila natyrisht lidhej dhe vinte për shkak të origjinës dhe gjendjes së tij shoqërore, si një shqiptar që jetonte e punonte jashtë, madje në SHBA, por ndikimi dhe autoriteti i madh që ai kishte tek udhëheqja e lartë shqiptare e asaj kohe?! Kjo gjë shihet më së miri te raport-informacioni që ka bërë për udhëheqjen e lartë, Kryetari i Komitetit për Marrëdhënie Miqësore dhe Kulturore me Jashtë, Jorgo Melica, ku shqiptari i diasporës, Agim Z..., në bisedën telefonike, e ka trajtuar atë, (Jorgo Melicën), as më pak dhe as më shumë, por si një vartës të bindur të tij... Jo vetëm kaq, por aty duket se Melica nuk ka pasur guximin ta kundërshtojë atë për asnjë gjë nga ato që ai i ka kërkuar, madje të zbatojë urdhrat e tij për të takuar ata persona që ai (Agim Z...) i ka sugjeruar dhe në fund të bisedës telefonike me shumë mirësjellje, apo më saktë me shumë frikë, i ka



Festivali i këngës popullore





Reiz Malile, anëtar i Komitetit Qendror dhe Ministër i Punëve të Jashtme

Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist...", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Reiz Malile
Tiranë, 25 korrik 1989

Shënimet me shkrim dore me letërën e ministrit Reiz Malile

Shoqja Lenka
Sapo më erdhi ky njoftim i shokut Reiz Malile
Mendoj që duhet të njiheni dhe ju me të dhe
Çporosi t'i japim. Është një histori e turbullt

Anastas
25 korrik 89

Përgjigjia e Lenka Çukos
E bisedova me shokun Simon e ata po e ndjekin si problem

Lenka Çuko




Komiteti Nr 188
Informacion

Më datën 22.8.1989, më morri në telefon nga Kanadaja kosovari Agim Z.... Centralisti i shërbimit më jashhtë pa më pyetur fare nëse doja të flisja apo jo, më lidhi direkt: Foli këtu Agim Z....? Agimi më pyeti: "Si jeni shoku Jorgo"? Të flas nga Kanadaja. Të fala keni dhe nga Ademi. Ai po punon për materiallet dhe së shpejti do t'u njoftojë". E pyeta: Po ju si shkoni? Dhe ç'ne tani në mëngjez? Keni ndonjë gjë urgjent? Më tha, tani këtu është ora 2. Sa mbarova drekën u interesova të të pyes nëse ju ka thënë gjë shoqëruesi Hulusi Hizmo, mbasi kur isha atje i kam thënë diçka për Eli Farën? I thash, s'di gjë. Hulusi është me pushime dhe nuk e kam takuar. Të lutem më tha ai, takojë dhe interesohu për problem-in tim. I thashë, tani e kam të vështirë se njerzit janë me leje, megjithatë do pyes. Pastaj Agimi më pyeti: A e ke takuar Reiz Begën? I thashë jo. Agimi u habit dhe më tha: Si ore nuk e ke takuar, ai ka disa ditë që ka ardhur në Shqipëri. Unë i kam thënë atij të interesohet për problemin tim. I thashë do

uruar dhe punë të mbarë bashkëbiseduesit që fliste nga SHBA-ja?! Sjellja përulëse e kreut të Komitetit të Kulturës ndaj "shqiptarit nga SHBA", vinte pasi Melica e njëjtte shumë mirë potencën apo statusin që kishte Agim Z...., te "shokët e udhëheqjes" në Tiranë, pasi vetë ai (Jorgo) në vitin 1986, me anë të një raporti zyrtar, ka njoftuar eprorët e tij në udhëheqjen më të lartë lidhur me Agim Z.... dhe gjithë aktivitetin dhe "punët" që ai kryente në SHBA, nëpër botë dhe në Shqipëri kur vinte për vizita pune... Iart. Nuk dihet me saktësi nëse Agim Z.... ka pasur vërtet takime dhe biseda me këngëtaresh e famshme Eli Fara, apo ato që përmenden në raport-informacionin e Melicës kanë qenë thjesht dëshira apo fantazira të tij...? Por, sa më sipër, nuk do të kishte dhe përbërte asgjë të keqe fakti, nëse ai ishte takuar vërtet dhe njihet me këngëtaresh simpatike korçare, apo dhe të kishin bërë plane së bashku, ashtu siç thuhet në raportin "Tepër sekret", për një takim të tyre, kur ajo do të ndodhej në Greqi me Ansamblin "Korça", ku Eli kishte filluar karrierën e saj si këngëtare. Gjithnjë sipas dokumenteve në fjalë, ndryshe nga dashamirësia e regjisorës së famshme Vera Grabocka, e cila i paska sugjeruar Agim Z.... që: "...nuk duhet që ta bisedojë me Komitetin ose shoqëruenin, por problemin e martesës me Eli Farën, t'ia ngrejë shokut Spiro Dede, i cili ka influencë tek udhëheqja dhe mund ta ndihmojë që të bëhet kjo martesë me Agimin". Jorgo Melica, sipas orientimeve, porosive apo urdhrave që ka marrë nga "shokët e udhëheqjes", nuk kanë tentuar ta thërrasin Eli Farën dhe ta këshilloinin atë, (që të hiqte dorë nga ajo lidhje, apo të njoftonte e të merrte leje në organet kompetente përkatëse), por ata kanë njoftuar Ministrinë e Brendshme për ndjekjen e saj?! Po kështu sa më

sipër, "shokët e udhëheqjes", nuk kanë tentuar dhe nuk kanë guxuar që për këtë problem, të këshilloinin, as Agim Z...., duke i thënë se problemi i martesës me këngëtaresh Eli Fara, duhet të zgjidhej jo në rrugë miqësore, por në rrugë ligjore si gjithë shtetasit e tjerë shqiptarë. Por ata kanë zgjedhur rrugën më të shkurtër, atë të survejimit dhe ndjekjen nga Sigurimi i Shtetit për këngëtaresh e njohur, ashtu siç ndodhte rëndom në atë kohë për të gjithë shkrimtarët e artistët dhe jo vetëm. Ashtu si dhe në pjesën më të madhe të dokumenteve të këtij libri, edhe këto publikohen të plota, por duke mos zbuluar identitetin e plotë të personazhit kryesor për të cilin bëhet fjalë në këtë kapitull.

Fleta e parë e "Dosjes Eli Fara" Sektori i Arsimit V 1989
Tepër - kujdes
Informacion i ardhur nga Komiteti i Marrdhënieve me Botën e Jashtme (Sh. Anastas) për Eli Farën
Tepër sekret
Shokut Anastas Kondo
Bashkëlidhur ju dërgoj një informacion lidhur me një bisedë që kosovari, Agim Z.... që banon në SHBA ka patur në telefon me shokun Jorgo Melica. Mundësisht problemi që trajtohet të shihet me kujdes.



ta takoj. Më falenderoj. I urova shëndet dhe punë të mbarë. Bëj të fala, tha, Shokut Spiro Dede. Më datën 24.7.1989, Izmini Haxhiu, punonjësi i Muzeut Kombëtar, më informoi se më datën 22.4.1989, e ka marrë në telefon Agim Z.... dhe i ka thënë: Kur kam qenë në Tiranë, kam biseduar me Eli Farën që të martohem. Eli Fara ka rënë dakort që të martohet më të, dhe djalin që ka nga martesë e parë, nuk do ta marrë me vete. Sipas Izminit, Agimi i ka thënë që Eli Fara më datën 15 gusht do të shkojë me Ansamblin "Korça" në Greqi dhe atje do ta presë Agimi për ta marrë me vete. Kur ka qenë këtu, këtë problem, Agim Z.... e ka biseduar me Vera Grabockën, regjizore në televizion, e cila sipas Izminit, i ka thanë se; që të rregullohet kjo punë, nuk duhet që ta bisedojë me Komitetin ose shoqëruenin, por problemin e martesës me Eli Farën, t'ia ngrejë shokut Spiro Dede, i cili ka influencë tek udhëheqja dhe mund ta ndihmojë që të bëhet kjo martesë me Agimin. Nga burime të tjera, mësojmë se kur ka qenë Agimi këtu, është takuar me Eli Farën, dhe Agimi e ka shoqëruar, dhe në ditën e largimit ka lënë dhe një pako me dhuratë. Për të gjitha këto, vumë në dje-ni Ministrinë e Punëve të Brendshme. Njoftuam dhe Drejtorinë e PTT se nuk na duket i drejtë veprimi i tyre se pa marrë mendimin tonë, na lidh direkt me një person me jashhtë. Jorgo Melica
Tiranë, më 24.7.1989

Arrestohet Dritan Sulollari. Mediat italiane: Krimi, pas sherrit për motive xhelozie

Shqiptari masakron bashkëshorten me thikë në sy të djalit 8-vjeçar

37-vjeçari telefonoi policinë: Kam vrarë gruan

ITALI

Një 30-vjeçare shqiptare është masakruar me thikë nga bashkëshorti në Udine të Italisë. Pas një debati, 37-vjeçari shqiptar, Dritan Sulollari ka goditur për vdekje nënën e fëmijës së tij, Migena Këllezin. Sipas mediave të vendit fqinj, krimi ndodhi mëngjesin e djeshëm në banesën e çiftit, në Gradisca d'Isongo, Gorizia. Mësohet se pas krimit në familje, autori Sulollari i ka telefonuar policisë duke thënë: "Hajdeni se kam vrarë gruan time". Sipas burimeve të mësipërme, e gjithë ngjarja ka ndodhur në sytë e djalit 8-vjeçar të çiftit. Dyshohet se 30-vjeçarja është vrarë pas një sherrit për motive xhelozie. Ndërkaq, mediat vendëse bënë me dije se kohët e fundit, zënkat mes çiftit të bashkëshortëve ishin bërë pjesë e rutinës së përditshme. Autoritetet italiane kanë vënë në pranga shqiptarin, ndërkohë që djali është marrë nga shërbimet sociale pas gjendjes së tij të rëndur.

VRASJA

Sipas italianes "TG-Com24", viktima Migena Këllezi është goditur me thikën e kuzhinës nga bashkëshorti Sulollari. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 09:00 të ditës së djeshme, pas një sherrit mes çiftit. Ndërsa gruaja ka dhënë shpirt nga goditjet e shumta, 37-vjeçari ka lajmëruar autoritetet për krimin dhe nuk ka tentuar të arratiset. Ai i ka pritur karabinierët në shtëpi. Menjëherë policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka vënë në pranga burrin vrasës. "Kur mbërritën në vendngjarje, shkruan - "TgCom24" - ata e gjetën autorin pranë trupit të pajetë të gruas 30-vjeçare, e cila kishte marrë plagë të rënda në trup". Migena Këllezi ndodhej në Itali prej disa vitesh, ajo i ishte bashkuar bashkëshortit të saj Dritanit, i cili punonte si



Viktima, Migena Këllezi



Autori i vrasjes Dritan Sulollari



kamerier në një piceri. Por, muajt e fundit, Dritani kishte mbetur pa punë. Sipas dëshmitëve të fqinjëve, familja shqiptare u përshkrua si një familje e qetë dhe askush nuk e kishte dëgjuar më parë çiftin të grindeshin, deri kur ndodhi tragjedia e mëngjesit të djeshëm. Mediat ital-

iane kanë marrë edhe prononcimet e fqinjëve të çiftit, të cilët janë shprehur të shokuar pas ngjarjes. Ndërsa njëra nga koleget e shqiptares që u vra u shpreh se, "Migena ishte një person i mrekullueshëm dhe gjithmonë ishte e buzëqeshur". Sipas të dhënave të para të

Vrasja në Udine, ministri Minniti: Ngjarje e papranueshme

Pas vrasjes së 30-vjeçares në sytë të fëmijës, në Udine, ka reaguar ministri i Brendshëm i Italisë, Marco Minniti, i cili ka dënuar ngjarjen e rëndë. Marco Minniti tha se jemi përballë një fenomeni shqetësues dhe të papranueshëm. "Një burrë vrau me thikë gruan në sytë e fëmijës. Ne po përballemi me një fenomen shqetësues dhe të papranueshëm. Ne duhet të jemi të vëmendshëm, nuk duhet ta ulim vigjilencën".



XHELOZIA

Sipas mediave italiane, dyshohet se 30-vjeçarja Migena Këllezi u vra nga bashkëshorti pas një sherrit për motive xhelozie. Po të njëjtat burime bënë me dije se kohët e fundit, zënkat mes çiftit të bashkëshortëve ishin bërë pjesë e rutinës së përditshme. Autoritetet italiane kanë vënë në pranga shqiptarin, ndërkohë që djali është marrë nga shërbimet sociale pas gjendjes së tij të rëndur.

medieve të vendit fqinj, shkaku i vrasjes ka qenë xhelozia e Dritan Sulollari, që solli debate të shumta në familje dhe që përfunduan me vrasjen e gruas.

SHKURT

Riattedhesohen 36 shqiptarë, nuk morën azil në Francë e Belgjikë

TIRANË - Pasditën e djeshme u riattedhesuan në aeroportin "Nënë Tereza" 36 shtetas shqiptarë, të cilëve u ishte refuzuar kërkesa për azil në Francë e Belgjikë. Ndërkohë, Policia Kufitare vijon zbatimin e masave shtesë për parandalimin e tentativave për azil në vendet e BE-së. Në Rinas ishin edhe përfaqësues të ambasadës franceze dhe oficeri i kontaktit në Shqipëri, të cilët asistuan në procedurat e riattedhimit të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së. Zvëndësinistria Romina Kuklo tha se shanset për azil janë zero. "Riattedhimi i sotëm (djeshëm) i shtetasve azilkërkuës në vendet e BE-së dëshmon edhe një herë angazhimin e Qeverisë shqiptare dhe Policisë së Shtetit, për të trajtuar të gjitha rastet e riattedhimit për azil dhe gjithashtu është edhe një thirrje për qytetarët shqiptarë, të cilët nuk duhet të marrin iniciativë për kërkim azili, pasi do të rezultojnë të pasuksesshme. Policia e Shtetit ka marrë masa shtesë për kontrollin e të gjitha pikave të kalimit kufitar, për parandalimin e këtyre rasteve. Kjo është një thirrje ndaj gjithë shqiptarëve, të cilët tentojnë të kërkojnë azil, për t'u thënë që shanset e tyre janë zero", deklaroi Kuklo. Drejtoresha e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Aida Hajnaj theksoi se duke iu referuar statistikave, numri i shtetasve që kërkojnë azil në vendet e BE-së është në ulje të vazhdueshme.

Sekeustrohen 42 kg drogë, prangoset shqiptari i kërkuar për tentativë vrasjeje

GREQI - Policia greke ka vënë në pranga një 31-vjeçar shqiptar, pasi u kap me drogë. Autoritetet fqinje ndoqën automjetin me të cilin vinte nga kufiri gjelbër dhe e ndaluan në zonën e Gorgomilos, në Prevezë. Mësohet se brenda në automjetin u gjetën dhe sekestruan në cilësinë e provës materiale 29 pako me 41 kg 252 gr marijuanë. Gjithashtu, shqiptarit, emri i të cilit nuk bëhet i ditur, iu sekestruan edhe 1300 euro, 1000 lekë shqiptare si dhe 2 celularë. Burime nga policia e vendit fqinj pohuan se automjeti tip "BMW", me të cilin lëvizte 31-vjeçari, në fakt i përkiste një shqiptari tjetër, i cili gjithashtu u shpall në kërkim. Nga verifikimet e policisë rezultoi se ndaj të arrestuarit shqiptar kishte dy urdhër-arreste, një për tentativë vrasjeje, si dhe një për trafik droge.

Mbushën shkollat e Athinës me drogë, ja si u kap banda me 8 shqiptarë

GREQI - Një grup të rinj shqiptarë janë arrestuar në Athinë, pasi akuzohen si trafikantë droge. Në operacionin e zhvilluar nga policia greke, ranë në pranga 8 shqiptarë dhe 2 grekë. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dy shqiptarë të

tjerë. Të gjithë të arrestuarit janë të moshës 18-26 vjeç. Autoritetet fqinje raportojnë se të rinjtë sillnin drogë nga Shqipëria në Greqi dhe e shpërndanin në shkolla, në zonat Zografo, Kaisarini, Pragradi dhe Virona. Tre muajt e fun-

dit kanë qarkulluar 12.5 kg marijuanë dhe kanë fituar rreth 100 mijë euro. Një gram marijuanë ata e shisnin për 5-8 euro. Gjithashtu, të rinjve iu sekestruan 1.5 kg marijuanë, 8000 euro, 1 pistoletë, 12 celularë, 3 makina dhe 1 motor.



Policia greke gjatë arrestimit të shqiptarëve.

SHIFRAT

Fatmira Nikolli

Buxheti i 2018-ës, Kultura përplaset me Financat

Ministria merr vetëm 2 miliardë, ankohet për pagat e rojeve dhe shpenzimet

46% e buxhetit shkon për paga e sigurime shoqërore, kërkohen 32 milionë lekë shtesë

Ministria e Kulturës për vitin 2018 i është dhënë një buxhet prej 2 miliardë lekësh të rinj, me një rritje prej vetëm 200 milionësh nga viti i kaluar. Edhe kjo, sipas vetë raportit për projektbuxhetin, prezantuar dje nga ministrja Mirela Kumbaro në Komisionin e Medias, është një rritje që vjen si rrjedhojë e rritjes investimeve me lekë.

ANKESA E SHQETËSIME

Së pari, Ministria e Kulturës thotë se në përlogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, janë kryer mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikës së re të Ministrisë së Kulturës, miratuar më 5 tetor 2017, e megjithëkëtë, vihet në dukje se ka një diferencë midis fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore sipas strukturës së aprovuar dhe projektbuxhetit 2018 në programet Trashëgimi Kulturor dhe Muzetë dhe Art&Kulture të cilat, thotë raportit i paraqitur para komisionit, "i kemi paraqitur dhe në relacionin e dërguar pranë Ministrisë së Financave. Besojmë se kjo diferencë do të plotësohet padyshim nga Ministria e Financave, sikurse u bë përgjatë vitit 2017". Ministria bën me dije se fondi pagave dhe sigurimeve shoqërore në totalin e buxhetit të Ministrisë së Kulturës përben 46.6% të buxhetit, çka do të thotë se pothuaj gjysma e buxhetit shkon për rroga e sigurime.

Në po këtë pikë, një tjetër shqetësim i ngritur ka të bëjë me shpenzimet korrente. Raporti i MK-së për projektbuxhetin e 2018-ës, thotë se "nuk është reflektuar rritje në buxhetin e ministrisë si rrjedhojë e VKM-së për rritjen e pagave për rojet, duke vënë në veshitësi Ministrinë e Kulturës në kryerjen angazhimeve të tjera që ka marrë në këtë fushë". Shtohet se kërkesat e Ministrisë së Kulturës me qëllim realizimin e misionit dhe objektivave të saj në drejtim të rritjes së buxhetit kanë qenë konstante.

"Fondi i cili kërkohet të shtohet në realizimin e prioritetëve dhe detyrave të saj, për sa më sipër, është në vlerën e 19 milionë lekëve për të siguruar këtë shërbim të domosdoshëm për institucionet e artit". Të njëjtin shqetësim ndan kjo ministri edhe për fushën e artit dhe kulturës, duke shënuar se "është mëse e nevojshme shtesa për shpenzimet korrente kryesisht për shërbimin e sigurimit dhe të ruajtjes, me një fond prej 13 milionë lekë, nevojë e domosdoshme".

Kumbaro bëri me dije se nga trashëgimia dhe arti: të ardhurat në vitin 2013 kanë qenë 61 milionë lekë ndërsa në vitin 2017 149 milionë lekë. E megjithëkëtë, "Ministria e Kulturës përballlet me një problem në përdorimin e këtyre të ardhurave nga ana institucioneve të varësishë, pasi tavanet që na vendosen nga Ministria e Financave, janë kundrejt të ardhurave të vitit 2013, ndërko-



Ministria e Kulturës

hë që të ardhurat tona nga sektori i biletarisë janë rritur ndjeshëm që nga 2013". Në vijim të ankesës, thuhet se sikurse edhe në kërkesat e mëparshme, "kërkojmë si ministri të rregullohet kjo anomali duke na u rritur tavanit buxhetor për shpenzimet korrente sipas udhëzimit të për-bashkët të të dyja ministrave të Financës dhe të Kulturës të vitit 2015, për përdorimin e biletave".

Sipas Kumbaros, për buxhetin e vogël të Ministrisë së Kulturës, kjo nuk është një shumë e pakonsiderueshme, por bëhet fjalë për rreth 26,6 milionë lekë nga të cilat në programin e trashëgimisë 22,4 milionë lekë dhe në programin e Art&Kulturë 4,2 milionë lekë, shuma me të cilat Ministria e Kulturës ka për objektivi të ndërhyjë në mirëmbajtjen e këtyre objekteve dhe në përmirësimin e shërbimeve dhe të produksioneve artistike, në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura akoma më të mëdha në vijim.

INVESTIMET

Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro ka përmendur dje në komisionin kantieret për restaurimin e 3 kishave të rëndësishme që do të përfundojnë vitin e ardhshëm. Shën Maria e Kosinës, Fjetja e Shën Marias e Sopikut, Shën Maria e Bënjës si edhe ka bërë me dije se janë gati projektet e do të fillojë, në bashkëpunim me Agjencinë turke TİKA, res-

TE DHENA	
BUXHETI NË ZËRA	
Planifikim, Menaxhim	160,276,000
Trashëgimi Kulturor dhe Muzetë	635,072,000
Art & Kulturë	1,214,549,000
Shuma	2,009,897,000
SHPENZIME E INVESTIME	
Paga+Sig. Shoqërore	937,500,000
Shpenzime korrente	396,237,000
Shpenzime nga të ardhurat	26,160,000
Investime me financim të brendshëm	650,000,000
Shuma	2,009,897,000

taurimi i 5 xhamive - trashëgimi kulturor, konkretisht:

Xhamia e Ethem Beut në Tiranë, Xhamia Mbret, Xhamia e Beqarëve, Teqeja e Helvetive në Berat dhe Xhamia e Pazirit në Gjirokastrë. Problem paraqet xhamia e Plumbit në Shkodër, për shkak të përmblytjes që vjen prej kolektorëve të bllokuar në vite nga ndërtime të paligjshme.

Pas shpalljes monument kulturor të Kuvenit të Troshanit, Kumbaro tha se është vendi i përshatshëm për një memorial për At Gjergj Fishtën.

Në kuadrin e vitit të Skënderbeut, ministria synon restaurimin dhe rikualifikimin e Memorialit të Skënderbeut në Lezhë, restaurimin e statujës së Skënderbeut në Krujë, si vende

simbol i Heroit Kombëtar dhe rikualifikimin e muzetit të vogël të Dibrës, ndërtaur në vendin e origjinës së Skënderbeut. Në mesin e investimeve për vitin 2018 u përmend përfundimi i teatrit të ri "Turbina", rikonstrukcioni i Teatrit të Operas dhe Baletit, ndërsa u bë me dije se konkretizohet në 2018-ën, puna për përgatitjen e konkurseve ndërkombëtare për të realizuar projektet për rikualifikimin, rehabilitimin dhe rifunksionalizimin e Muzeut Historik Kombëtar, të Galerisë Kombëtare të Artit si një Muze i Historisë së Artit dhe të rikonstrukcionit të Bibliotekës Kombëtare.

PËRPARËSITË

Tek arti dhe kultura, sipas ministres investimet kulturore do të

kenë prioritet riorganizimin e kapaciteteve profesionale dhe rikonceptimin e programeve të Institucioneve Qendrore të Artit dhe Kulturës. Programi Kombëtar "Edukimi përmes Artit" do të jetë vijimi i një reforme të thellë dhe të qëndrueshëm në institucionet e artit dhe politikave kulturore. Ndërkaq, Ministria e Kulturës do të ofrojë paketa dhe shërbime kulturore të përqendruara kryesisht në vijën bregdetare në shërbim të turizmit kulturor.

Në sajë të motos, 'Kultura si pasaporta jonë më e mirë', ajo tha se do të realizohen një rrjet aktivitetesh, që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike dhe zhvillimit të diplomacisë kulturore në nivele të larta ndërkombëtare, promovimit e artit shqiptar në arenën ndërkombëtare (Viti Skënderbeut, Creative Europe, Traduki, Kalendari Shqipëri-Kosovë, Kalendari artistik me Maqedoninë, Bienalja e Venecias e arkitekturës, panairi ndërkombëtare të librit).

'Parku i artit' është një tjetër projekt që do të realizohet në bashkëpunim me rajonin e Puljas dhe konsiston në rikualifikimin e hapësirës së parkut të Kinostudios, duke restauruar dhe përdorur instalacione artistike dhe arkitekturore të skulpturave të oborrit të GKA.

Buxheti 2018 do të shërbejë edhe në mbështetjen e aktivitetëve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e trashëgimisë kulturore, artit dhe kulturës, librit, përkthimit, krijimtarisë së re në dramaturgjë dhe muzikë, këtyre të fundit do t'u kushtohen edhe konkurse kombëtare të dedikuara. Synim mbeten projektet e qëndrueshme e afatgjata, që integrojnë kulturalisht Shqipërinë në axhendat ndërkombëtare. Përparësi është viti kulturor Austri-Shqipëri, që do të mbështetet nga Ministria e Kulturës me një kalendari tashmë të konsoliduar midis dy vendeve, që starton javën tjetër në Vjenë, por do të kulmojë në vitin ardhshëm.

QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT DHE LEXIMIT


Theks prej kohësh është leximi dhe libri. Ndërsa prej dy vitesh mbahet muaji i leximit, Kumbaro ka njoftuar dje se për një politikë sa më të qëndrueshme dhe të decentralizuar në fushën e librit, synohet ngritja e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, që ka si objektivi themelor mbështetjen dhe promovimin e letrave shqipe brenda dhe jashtë vendit, hartimin dhe zbatimin e projekteve në ndihmesë të rritjes së kulturës së leximit, krijimin e një rrjeti bashkëpunues dhe mbështetës mes shkollës, familjes, institucioneve librare e bibliotekare për edukimin nëpërmjet leximit.

FESTIVALI

Jeta e 'fshehtë' e baronit Franc Nopcsa në një dokumentar

Lidhja e tij me shqiptarin dhe fundi tragjik

Doda - The life and adventures of Franz Baron Nopcsa'. Është ky titulli i dokumentarit që u shfaq mbrëmë në Teatrin e Kukullave në Tiranë në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë, TIFF 2017. Realizimi i filmit ka nisur vite më parë, kur regjisori e skenaristi Visar Vishka, pa krenjtë rastësisht një fotografi të Bayazid Elmas Dodës dhe Franz Baron Nopcsës. Nisi prej atij imazhi një humlumtim i gjatë për të mësuar historinë që fshehej pas tij. Kush ishte në letërën e Nopcsës, kanë shkruar mediat. Hipotezat për vrasjen e vetëvrasjes janë disa, e mes tyre nuk mungon xhelozia e tradhtia.




Nopcsa për pak edhe mund të bëhej Mbret i Shqipërisë. "E bëra këtë vrasje, pasi Doda nuk do të kishte mundur të jetonte pa mua. Do t'i dhimbte shumë", thuhet në letërën e Nopcsës, kanë shkruar mediat. Hipotezat për vrasjen e vetëvrasjes janë disa, e mes tyre nuk mungon xhelozia e tradhtia.



KUSH ISHTE NOPCSA

Sipas Robert Elsie, albanologu i njohur hungarez, baroni Franc Nopcsa nga Felshësilvashi [1877-1933], ishte një ndër studiuesit më të spikatur të kohës. Ai ishte lindur në një familje aristokratike hungareze më 3 maj 1877. Me rekomandimin e ungjit dhe kumbarit

të tij, Franc von Nopcsa, kryemjeshtër i oborrit të Mbretëreshës Elisabeta të Austrisë, Nopcsa mbaroi maturën në liceun vjenetz MariaTheresianum. Franc Nopcsa udhëtoi gjerësisht në Ballkanin jugperëndimor dhe jetoi për një kohë në fillim të shekullit të njëzetë në Shkodër. Në vitet e mëvonshme ai u bë i njohur gjithashtu si një ndër albanologët kryesorë të kohës së tij. Botimet e tij albanologjike nga vitet 1907 deri në 1932 u përgjendruan kryesisht në fusha të tilla si: parahistoria dhe historia e lashtë, etnologjia, gjeografia, historia e re dhe e drejta zakonore shqiptare, d.m.th. kanuni. Lista e botimeve të Nopcsës përmban më shumë se 186 tituj, kryesisht nga fushat e paleon-



Regjia & Produksioni:

Visar Vishka
Kinematografia:
 Filip Kondovski
Montazhi:
 Zoran Chanovski
Animacioni:
 Aleksandar Stojanovski

tologjisë, të gjeologjisë dhe të albanologjisë. 54 botime janë për Shqipërinë. Ndër veprat më interesante të Nopcsës janë kujtimet e tij, të botuara gjermanisht në vëllimin [Udhëtime në Ballkan: kujtimet e baronit Franc Nopcsa].

DY FILMA, DY FESTIVALE, DY TERRITORE, DY PROJEKSIONE DHE NJË PLATFORMË VOD

Projektionin simultan të filmit për fëmijë "Raffi" dhe filmit "Fado" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë, Festivalit European të Filmit "Cine-days" dhe në platformën "VOD Cinesquare.net": "Fado" - 10 nëntor, 2017, në orën 17:00 dhe "Raffi" - 11 nëntor, 2017, në orën 11:00. "Cutaway Films Distribution" ka lançuar që prej vitit 2016 "Festivalin Simultan", një nisim risi e shpërndarjes, e cila i bën filmat njëkohësisht të vlefshëm në festival dhe në internet në rajonin e Ballkanit. Edicioni i fundit përfshiu shfaqjen e filmit holandez "Clean Hands" më 11

nëntor, 2016, në orën 17:00, në Festivalin European të Filmit Cine-days dhe në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë. Ky edi-



cion përfshin shfaqjen simultane në festival të dy filmave, më datë 10 dhe 11 nëntor 2017, respektivisht në orën 17:00 dhe 11:00, në Festivalin European të Filmit Cine-days dhe Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë, si dhe në platformën "VOD Cinesquare.net" në të dyja vendet. Kjo nisim mbështetet nga programi MEDIA i 'Creative Europe' për të testuar terrenin e shpërndarjes inovativ që i ofron publikut zgjedhje në

shikimin e prodhimeve cilësore europiane dhe fuqizon disa filma, që përndryshe do të prekin vetëm disa shryes me fat të pranishëm në festivale. Gjithashtu, përmirëson marrëdhëniet mes festivaleve, shpërndarësve, agjentëve të shitjes dhe platformave VOD, për t'i sjellë publikut filma cilësorë europianë. Festivali simultan e vendos Tiranën në hartën e filmit dhe distribucionit të filmit european.

JEP DORËHEQJEN KRYETARI GUDAR BEQIRAJ, AKADEMIJA E SHKENCAVE MERR BUXHET NGA QEVERIA E I SHPËTON SHKRIRJES

Kryetari i zgjedhur në shtatë Akademi të Shkencave, Gudar Beqiraj ka dhënë dorëheqjen nga detyra, ndërsa Akademi e është rikthyer buxheti nga qeveria. Megjithatë i zgjedhur me vota nga akademikët, pas debateve që nisën me Artan Fugën, duke përfshirë kryeministrin Edi Rama, që kërcënoi për prerje fondesh, Akademia mbërriti në shkrirje pasi as Presidenti nuk e dekretonte Beqirajn. Kthesa ka ndodhur ditën e djeshme. Në Komisionin Parlamentar të Medias lajmi për rikthimin e buxhetit Akademi është dhënë nga Ministria e Financave. Si fond do jetë i njëjti sa vitet e kaluara. Në emër të Ministrisë së Financave në komisionin parlamentar foli zëvendësimin e ministrit Dajna Sorensen. Fondi i përvitshëm i Akademi së Shkencave është rreth 96 milionë lekë të rinj. Kryeministri Edi Rama deklaroi pas zgjedhjeve në Akademi e Shkencave, se



Akademiku Gudar Beqiraj me Presidentin e Republikës, Ilir Meta

ky institucion duhet t'i gjejë vetë fondet e financimit, pasi në vend të reformimit zgjidhi farsën (megë në krye të Akademi së zgjedh ish-kryetari). Nga ky buxhet, 94 milionë janë shpenzime korrente, paga dhe vetëm 2 mln lekë të reja investime. Për ç' arsye, heqja e buxhetit do të çonte në shkrirjen

e Akademi së. Ndërkryetari i Republikës së Shqipërisë ka pritur në takim kryetarin e zgjedhur të Akademi së Shkencave, akademikun Gudar Beqiraj ku mes të tjerash u diskutua mbi situatën aktuale të Akademi së Shkencave, procesin e reformimit të saj dhe sfidat dhe perspektivën e përballjes së tyre me sukses. Sipas njoftimit, gjatë bisedës u nënvizua nevojja dhe rëndësia e një reformimi tërësor të kërkimit shkencor dhe Akademi së Shkencave në drejtim të rritjes së produktivitetit shkencor në harmoni me zhvillimet e sotme të shkencës, teknologjisë dhe inova-

cionit, për përballimin e sfidave të rëndësishme të vendit tonë. Gjatë takimit akademikun Beqiraj i shprehu vullnetin e tij Presidentit të Republikës për t'u dorëhequr nga pozicioni i kryetarit të zgjedhur të Akademi së Shkencave, duke theksuar se ai do të mbetet përkrah kolegëve të tij akademikë, mbështetës dhe kontribues, i procesit të reformimit të nisur tashtë të këtij institucioni të rëndësishëm. Presidenti i Republikës Meta vlerësoi aktin e Beqirajt duke vënë në dukje personalitetin e tij dhe rolin e kontributit e gjatë jo vetëm në fushën e kërkimit shkencor, por edhe në atë të zhvillimit të sportit dhe të veprimtarive humanitare. Presidenti i Republikës Meta theksoi rëndësinë e vendosjes sa më shpejt të dialogut mes Asamblesë së Akademi së Shkencave dhe qeverisë me qëllim rritjen e rolit të pazëvendësueshëm të saj për zhvillimin e vendit.

Opinion *i* Ditës

Nga Vasil Kureta

(Vijon nga faqja e parë)

Një shekull nga fitorja e revolucionit të tetorit, me realizëm, pa nihilizëm

... dhe menshevikëve rreth zhvillimeve në Rusi, u dëshmuua se vizioni më ndryshues, më bindës, më të qartë, më bashkues dhe më afër kërkesës historike të zhvillimeve në Rusi e kishin bolshevikët, me platformën e tyre të ngjitur mbi konceptin e Marksit, për një shoqëri të re, të drejtë, të lirë, pa shfrytëzim të njeriut nga njeriu. Edhe pse Marksit mendonte se ky model mund të fillonte në vendet më të zhvilluara ekonomike e sociale, Lenini dhe bolshevikët nxituan ta aplikojnë në një Rusi të prapambetur dhe me elementë thelbësorë të modelit feudal të zhvillimit, që ishte në fillimet e marrëdhënieve kapitaliste në prodhim. Revolucioni Bolshevik realisht hapi rrugën e një ndryshimi thelbësor, fillimin e një modeli të ri të zhvillimit, një epokë të re në zhvillimet botërore.

Fitorja e tij mundësoi krijimin e një modeli të ri të zhvillimeve ekonomike, politike e sociale, një modeli tjetër zhvillimi në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Pas kësaj fitoreje e ndryshimi cilësor historik, u shtrua një mundësi e re dhe një përballje frontale mes dy mënyrave të kundërta të zhvillimit e organizimit ekonomik, politik e social dmth., midis atij perëndimor ose ndryshe kapitalist dhe atij socialist, të frymëzuar nga vizioni i Marksit dhe i interpretuar e zbatuar nga Lenini e më pas nga Stalini. Me këtë ngjarje bota kishte ndryshuar e do të kishte në thelb dy botë të kundërta mes tyre, që do të ishin në provë të vërtetë, në garë për të fituar e mundur njëri-tjetrin, në përballje gjithnjë e më të fortë, më të gjithanshme e më armiqësore mes tyre. Kjo përballje realisht ndikoi në evolucionin e shoqërisë njerëzore, në konkretizimin e ndryshimeve të vërteta ekonomike e sociale, në formësimin e dy modeleve të kundërta të zhvillimit, të atij kapitalist, që ishte i konsoliduar dhe atij socialist, që pretendonte ta kapërcente në standardet e nivelet e zhvillimit ekonomik e social e sidomos që pretendonte, se i kishte rrëmbyer tashmë modelin kapitalist flamurin e mbrojtjes së lirive e të drejtave të njeriut. Kjo ambicie u zhvillua më tej, pas goditjes së rëndë që modeli kapitalist pësoi me krizën e rëndë të viteve '30 të shekullit të kaluar, me lindjen brenda modelit kapitalist të dy monstrevë të nazizmit e fashizmit dhe sidomos pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe krijimit të kampit socialist. Revolucionin e tetorit më 1917 ishte produkt i pjesëmarrjes së gjerë të burrave e grave, të të rinjve, punëtorëve e fshatarëve e popullit rus, që aspironin lirinë e zhvillimin, një mënyrë tjetër më të mirë jetese, lirinë e vërtetë të zhvillimitin e gjithanshëm. Është fakt se ata përbënin shumicën e bashkuar që kërkonte ndryshimin cilësor e zhvillimin e vërtetë, por që i kishin besuar kështu vizionit komunist marksist. Edhe pse mund të mos dinin e kuptonin shumë nga vizioni i Marksit dhe ai që u përcollti Lenini me bolshevikët, ata kërkonin një model tjetër



zhvillimi, me liri, demokraci, dinjitet njerëzor dmth., me referim të sistemit i vlerave të larta njerëzore.

Frymëzimi nga këto vlera dhe nevoja për ndryshim thelbësor u bë shkaku esencial i bashkimit dhe pjesëmarrjes së gjerë sociale, që solli ngjarjen e rëndësishme historike, faktin e ndryshimit të madh në zhvillimet botërore. Pas fitores së revolucionit socialist të tetorit, do të kishte dy botë, dy modele zhvillimi, dy filozofi e botëkuptime të kundërta e në luftë të ashpër mes tyre. Bolshevikët u bënë të besueshëm, sepse inspironin ndryshimin e gjendjes dhe ofronin një perspektivë të re zhvillimi, ndryshe nga ai ekzistuesi. Vlerë e revolucionit të tetorit u bë ndryshimi, që tashmë ishte shndërruar në një stimul e nevojë jo vetëm për Rusinë, por edhe përtej saj. Pas fitores në luftën e madhe patriotike, që mposhti përfundimisht hordhinë naziste. Mëkulla u bë realisht qendra e komunizmit botëror dhe modeli rus u aplikua në vende të tjera, që u bënë pjesë e kampit socialist. Edhe modeli perëndimor në përballjen me modelin e ri, gjeti një stimul konkret vetëpërsosjeje e ndryshimi, që dëshmoi shumë herë më efektivitet e epërsi ndaj atij social-

ist dhe që e mundi më pas atë.

Nëse e vështron me realizëm historinë që nga fitorja e Revolucionit Bolshevik, deri te rrëzimi i komunizmit në fund të viteve '80, atëherë do të konstatohe se brenda modelit socialist, në hapësirën e kampit socialist, ka shumë elementë pozitivë e negativë, arritje e dështime, avancime dhe gabime, zhvillime dhe regres, ndryshime dhe krime, më shumë prirje nga centralizimi i vendimmarrjes dhe përqendrim autoritarist të pushtetit, luftë të ashpër klasash, në shumë dhunë sidomos edhe ndaj fjalës së lirë, duke e diskredituar realisht flamurin e lirive e të drejtave të njeriut, që pretendonte se ia kishte rrëmbyer modelin kapitalist. Këto dukuri u shfaqën me veçori konkrete në secilin vend socialist, deri sa modeli u kolapsua, dështoi dhe solli shpërbërjen e BRSS dhe vetë kampit socialist, pa ndonjë ndërhyrje ushtarake nga jashtë. Pra, kishte një përballje e luftë totale mes dy modeleve për ta mundur njëri-tjetrin e jo thjesht një garë. Modeli perëndimor arriti të sigurojë rendimentin më të lartë në punë në këtë përballje modelesh, një zhvillim ekonomik me standarde të larta e vëllim tepër më të lartë, një nivel mirëqenieje

për qytetarët shumë herë më të lartë, edhe pse në praninë e dallimeve tepër të ndjeshme mes shtrësive sociale, mundësi të gjera të iniciativës së lirë, funksionim të demokracisë e sundim të ligjit, hapësirë të gjerë për liritë e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre. Modeli perëndimor u përsos duke qëndruar fort në sistemin e vlerave, që dhe volosi fundin e pashmangshëm të modelit socialist. Edhe pse sot ky model fitues po has mjaft vështirësi e probleme, jo të thjeshta e të vogla, përsëri përfaqëson modelin më të lartë që ka sot njerëzimi në evolucionin e tij.

Gjithë kjo histori është parë e vlerësuar edhe aktualisht edhe me realizëm e vërtetësi objektive, por edhe me subjektivizëm, nihilizëm, zbulurime e fsheljes së të vërtetave e pse jo me nostalgji konkrete. Natyrisht, që liria e mendimit është e drejtë e pamohueshme dhe këndvështrimet janë të ndryshme, por të gjitha këto pozicione janë përballë të vërtetës së fakteve e ngjarjes historike. Faktet dhe vërteta historike të mundësojnë të gjykojnë drejt. Njëanshmëria nuk është metodë efektive gjykimi edhe për këtë përvojë historike, që kishte kurbën e vet të ecurisë së ndryshimit dhe jo vetëm dësh-

timin e fundin e vet. Është fakt që modeli socialist, në mënyrën se si u konceptua e realizua, pati rezultatet e tij të pamohueshme, sidomos në fazën e parë të shtrimit të tij, por që më pas u kolapsua, e mbylli kapitullin e vet, duke lënë pas një diskutim, një çështje e mbyllur tashmë, që i takon historisë, por edhe për shqyrtime realiste dhe objektive. Për disa Revolucioni i tetorit përkujtohet më shumë sot nga pozicione e për interesa nacionaliste dhe në funksion të një modeli autoritarist qeverisjeje. Për disa, historia ka parë njëqind vjet më parë një Revolucion Bolshevik, si një formë e shfaqjes së determinizmit komunist dhe në fund të këtij shekulli, një histori me një ironi tragjike. Ka gjithashtu edhe një diskutim në rrafshin teorik brenda simpatizantëve të mendimit marksist, sipas të cilëve, dështimi i modelit socialist ishte rrjedhojë edhe i shmangies nga idetë kryesore dhe filozofia apo kuptimi i Marksit për çështje thelbësore të shoqërisë komuniste në të dyja fazat e saj, që nga çështja se ndryshimi e revolucionet do të ndodhin në vendet më të zhvilluara kapitaliste, por dhe për çështjen e tjetërsimit apo të kalimit nga pushteti i sendeve mbi njerëzit të pushteti i njerëzve mbi sendet, mbi rolin e shtetit në zhvillimet ekonomike e sociale dhe kuptimin e tij për shuarjen e shtetit etj.

Fakt i pamohueshëm është se Revolucionin Bolshevik solli një ndryshim thelbësor në evolucionin e marrëdhënieve ndërkombëtare, që u thellua më tej me krijimin e kampit socialist, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Ai i hapi rrugën një modeli tjetër ekonomik, politik e social, i kundërt me atë kapitalist që kishte filluar jetën e vet me fitoret e revolucioneve borgjeze. Edhe rrëzimi i komunizmit, shpërbërja e BS dhe e kampit socialist, hapi rrugën për një model të ri të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare, që është në proces kompletimi. Federata e Rusisë tashmë nuk pretendon se zhvillon modelin komunist, por që synon një rol superfuqie botërore në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo ka një model ku gjen edhe ekonominë e tregut, edhe demokracinë elektorale, edhe centralizimin e lartë në qeverisje, ku opozita politike ka vështirësi të mëdha të realizojë misionin e saj dhe përfaqëson një vend të madh, me potenciale të mëdha zhvillimi, me histori, kulturë e kontribut të pasur në zhvillimet botërore. Për disa, Rusia sot përfaqëson një superfuqi të re me interesa konkrete imperiale, që do të ndikojë ndjeshëm në zhvillimet botërore.



17-vjeçari Leonardo Frrokaj u dëmtua gjatë garës

Thyen shtyllën kurrizore, në koma mundësi shqiptar

Një lajm i rëndë ka tronditur mundjen shqiptare ditën e martë, ndërsa në garën për medaljen e arit për ballkanadën e mundjes së 17-vjeçarëve që po zhvillohet

në Slloveni, mundësi shqiptar, Leonardo Frroku, ka pësuar një dëmtim të rëndë gjatë garës duke thyer shtyllën kurrizore, teksa është shtuar me urgjencë në spital. Njoftimin për ngjar-

jen e rëndë e ka dhënë ministria Lindita Nikolla, që theksoi se të gjitha strukturat shtetërore janë vënë në lëvizje për t'i ardhur në ndihmë sportistit të ri. Presidenti Biba theksoi se

gjendja e djaloshtit është kritike dhe falënderon angazhimin e mjekëve sllovenë, të cilët kanë kryer edhe një operacion të vështirë prej 4 orësh. Situata e 17-vjeçarit mbetet e rëndë, ndërsa ai qëndron në gjendje kome. Mjekët po përpiqen që t'i rikthejnë frymëmarrjen natyrale dhe lëvizjet e gjymtyrëve, ndërsa për të është planifikuar një tjetër ndërhyrje kirurgjikale.

Dy mesfushorët e Kombëtares së 21-vjeçarëve presin mbështetjen e tifozëve në "Selman Stërmasi"

Ndoj e Ramadani duan 'kokën' e Irlandës së Veriut

Fitorja mban gjallë shpresat për kualifikim



Jeton Selimi

Shqipëria nuk ndihet inferiore ndaj rivalëve në arenën europiane, kjo jo vetëm për sa i përket skuadrës së parë, por vihet re edhe të moshat. Kombëtarja e 21-vjeçarëve të Shqipërisë bëhet gati për të luajtur ndeshjen e 5-të eliminatore ndaj Irlandës së Veriut në Grupin 2 për Europianin e kësaj grupmoshe, që do të zhvillohet në Itali verën e ardhshme. Kjo shihet në fjalët e futbollistëve të grumbulluar nga trajneri Alban Bushi, teksa në konferencën për shtyp, Emanuele Ndoj dhe Ylber Ramadani ftojnë tifozët për t'i dhënë zemër ekipit për një objektivi madhor. "Kërkojmë fitoren për të kaluar grupin dhe të shkojmë në Europian. Jemi përgatitur mirë dhe shpresojmë për fitore ndaj Irlandës së Veriut. Është mirë të luajmë me përgënjendrim, shpresojmë për fitoren", theksoi Emanuele Ndoj, ndërsa Ylber Ramadani shtoi: "Që nga dita e parë jemi të përgënjendur, duhet të hyjmë në fushë pa eufori dhe të fitojmë



ndeshjen. Takimi luhet në Tiranë, ndaj dua të ftoj të gjithë tifozët, sepse kemi nevojë për ta". Shqipëria e 21-vjeçarëve ka grumbulluar 5 pikë në 4 ndeshje, ndërkohë që në Irlandën e Veriut u thyen në sfidën e parë në kohën shpresë me një penallti. Në fut-

boll nuk ka vend për hakmarrje, edhe pse është një sport, që shpeshherë vendoset nga episodet. Djemtë e Bushit janë të bindur që skuadra ka bërë lojën më të mirë nga të gjithë kundërshtarët në këto eliminatore, por ka diçka që nuk shkon. "Mund të kishim më shumë

pikë, pasi kemi treguar lojë të mirë. Kemi pasur shanse shënimi, kemi humbur raste, por shpresojmë të marrim pikët e plota. Na mungon sulmuesi, por jemi të gjithë lojtarë të mirë dhe shpresojmë të shënojmë dhe të fitojmë. Kemi zhvilluar gjithmonë lojë të bukur, por

tani duhet ta shoqërojmë edhe me gola", tha mesfushori i Breshias, ndërsa mesfushori i Vejles shton se fitorja ndaj irlandezëve nuk është hakmarrje. "Nëse e fitojmë ndeshjen, kemi shanse të mira, sepse në këto kualifikime kemi bërë lojën më të mirë nga të gjitha ekipet dhe besoj se do të fitojmë. Mendoj që nuk është revansh, sepse në futboll janë të 3 rezultatet dhe këtë ndeshje duhet ta fitojmë si ekip. Objektivi ynë është vendi i 2-të në grup, por ne hyjmë në çdo ndeshje për të fituar". Të dy mesfushorët kanë gati recetën se si mund të fitohet ndaj Irlandës së Veriut, duke qenë se është një kundërshtar, të cilin e njohin. Emanuele Ndoj: "Kemi ekip më të mirë se ata, pasi luajmë në mbrojtje me topa të gjatë". Ylber Ramadani: "Duhet ta qarkullojmë topin sa më shpejt, pasi ata luajmë me topa të gjatë, duhet t'i neutralizojmë".

KATEGORIA SUPERIORE

Faza e dytë në mesjavë, zyrtarizohet programi

Superiorja luhet mesjavën e ardhshme, teksa zhvillohen disa ndeshje të rëndësishme të ndara në dy ditë. Të mërkurën zhvillohen shumica e takimeve, dy prej tyre prej orës 14:00. Sfidat hapëse të javës së dhjetë janë Vllaznia-Lushnja (ende nuk dihet se ku do të luhet ky takim) dhe Luftëtari-Teuta. Tri orë më pas Flamurtari dhe Skënderbeu përballen mes tyre në Vlorë. Të dielën, të dyja ndeshjet luhen në të njëjtin orar, me Laçin që pret Partizanin dhe Kamzën, që në shtëpi do kërkojë fitoren me kampionët e Kukësit.

KATEGORIA SUPERIORE

JAVA E 10

TË MËRKURËN

Vllaznia - Lushnja	14:00
Luftëtari - Teuta	14:00
Flamurtari - Skënderbeu	17:00

TË ENJTEN

Laçi - Partizani	14:00
Kamza - Kukësi	14:00

Me Skënderbeun mund të kthehen tifozët

Pas skandalit me "pulat", Apeli ul dënimin e Flamurtarit

Komisioni i Apelit në Federatën Shqiptare të Futbollit ka zburur disi përmasat e skandalit me dënimin e dhënë kundër skuadrës së Flamurtarit për parullën e famshme të pulave të shpalosur nga tifozët. Në mbledhjen e djeshme, komisioni ka vendosur të ulë dënimin e vlonjatëve sa i përket numrit të ndeshjeve që do të luajnë pa tifozë. Pas bujës që mori vendimi skandaloz i Disiplinës, Apeli ka zbritur nga 4 në 2 numrin e ndeshjeve pa tifozë për ekipin e Flamurtarit, duke u dhënë mundësinë kësaj vlonjatëve që të luajnë që në takimin e radhës në fushën e tyre, atë kundër Skënderbeut, me praninë e tifozëve pas pagesës së gjobës.



Nga kampi kuqezi në Antalia

Kombëtarja zhvillon stërvitjen e radhës, vetëm vrap për Bashën



situatë taktike të lojës. Ndërkaq, vijon të stërvitet i diferencuar Migjen Basha, i cili dje ka bërë disa ushtrimë të lehta dhe më tej ka vijuar me vrap të lehtë.

Kombëtarja shqiptare zhvilloi ditën e djeshme stërvitjen e dytë në Antalia, ku të hënën do të luajë takimin miqësor me ekipin kombëtar turk, të drejtuar nga trajneri Luçesku. Njëpër një postimi në "Facebook", zyra për shtyp e FSHF-së njofton se trajneri Panuçi u fokusua më shumë në pjesën taktike, duke zhvilluar ushtrime të ndryshme në fushë sipas ndarjes së planifikuar. Në 20 minutat e fundit, italian i zhvilloi një min-ndeshje, për të vlerësuar

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

